

REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
BASHKIA LIBRAZHD  
KËSHILLI BASHKIAK

0296

18.12.2025

Librazhd më: 17.12.2025

NJOFTIM

“PËR MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË”

Z.znj. \_\_\_\_\_

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 53 pika 2 dhe pika 4, ju njoftojmë se ditën e **Martë, datë 23.12.2025**, ora 10:00 do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak për muajin **Dhjetor** 2025. Mbledhja do të zhvillohet te Salla e Këshillit në Bashki me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.11.2025.
3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha nëntor 2025”.
4. **P/Vendim** “Për miratimin e paketës fiskale (taksave dhe tarifave vendore), në Bashkinë Librazhd për vitin 2026”.
5. **P/Vendim** “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Librazhd për vitin 2026”.
6. **P/Vendim** “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve Administrativ të Bashkisë Librazhd dhe Istitucioneve të varësisë.”
7. **P/Vendim** “Për miratimin e listës së projekteve prioritare në infrastrukturën e Bashkisë Librazhd për vitin 2026-2028”.
8. **P/Vendim** “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 të bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2026-2028”.
9. **P/Vendim** “Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe vitit buxhetor 2027”.
10. **P/Vendim** “Për miratimin e listës së familjeve që plotësojnë kushtet për programin e subvencionimit të qirasë për vitin 2026”.
11. **P/Vendim** “Mbi ndarjen e bursave për nxënësit e viteve të para të Arsimit Profesional për vitin shkollor 202-2026”.
12. **P/Vendim** “Për miratimin për dhënie bursash për nxënësit e arsimit Parauniversitar në shkollat publike në bashkinë Librazhd”.
13. **Të ndryshme:**

- *Ditën e hënë datë 22.12.2025 ora 10:00 të mbliidhen Komisionet te Salla e Këshillit Bashkiak.*

KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BICAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
BASHKIA LIBRAZHDE  
KËSHILLI BASHKIAK

PROCEVERBAL I MBLEDHJES 26.11.2025

- I mbajtur sot më datë 26.11.2025 në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd.
- Pasi u lexua rendi I ditës nga Kryetari i Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 14vota pro.  
Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu (Këshilltarët e pranishëm).

- Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 28.10.2025 me të gjitha votat e të pranishmëve 14 vota pro.  
Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu (Këshilltarët e pranishëm).

- **Miratohet fillimi I mbledhjes me ketë rend dite si më poshtë vijon:**

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.10.2025.
3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha tetor 2025”.
4. **P/Vendim** “ Për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik”.
5. **P/Vendim** “ Për rritje e pakësim plani buxhetor të vitit 2025 të të ardhurave vendore”.
6. **P/Vendim** “ Për linjat kryesore dhe oraret e transportit rrethqytetas”
7. **P/Vendim** “ Për miratimin e ndërhyrjeve në pronë publike për efekt të mbrojtjes së pronave private”.
8. **Të ndryshme:**
  1. **P/Vendim** “ Për emërtimin e prishjes së nënobjektit “Palestra e shkollës 9-vjeçare Vilson Blloshmi” Librazhd.
  2. **P/Vendim** “ Shtesë fondi për klubin e futbollit Sopot”.
  3. Prezantimi dhe Diskutimi i Raportit të Performancës të Bashkisë Librazhd , viti 2024.

**Kërkesë:**

**Dorheqja e Kryetarit të fshatit Librazhd Katund Z.Urim Mana.**

### **Fillimi i mbledhjes:**

**1.P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha tetor 2025”.

#### **Këshilltarja ,Arjana Çekrezi e merr fjalën;**

Ky p/vendim tani dihet tashmë për çfarë bëhet fjalë,ne jemi njohur me materialet dhe une peronalisht jamë pro.

#### **Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.**

Sa konkretë janë si zyrë ? Si funksionon verifikimi i familjeve në terren? Dhe sot familjen nga Gizaveshi nuk e shikoj në listë fituese.Dhe ndihmat që shpërndani ,çfarë procedure ndiqni?Bashkia me çfarë e ndihmoj konkretisht familjen Buzra nga Gizaveshi?Çfarë kriteri duhet të plotësohet që të përfitohet ndihma ekonomike?

#### **Përgjegjësi i Ndhmës Ekonomike z.Rexhep Shaka e merr fjalën;**

Sa për rastin e familjes nga Gizaveshi,kjo familje trajtohet me ndihmë ekonomike,ne familjen Buzra e kemi ndihmuar dhe vazhdojmë ta ndihmojmë,e kemi ndihmuar me rregullimin e ambientit të mbrendshëm dhe të jashtëm,me ndihma ushqimore,me mobilje etj.

#### **Këshilltarja ,Xhuljeta Boriçi e merr fjalën;**

Si i përzgjidhni familjet përfituese për ndihmën ekonomik? Pasi kam një rast që një familje I hiqet ndihma ekonomike dhe familjes tjetër jo,ku te dyja familjet janë njësoj,si i bëni verifikimet në terren?Mos hiqni familje që vërtetë janë në nevojë.Ne si këshilltar duhet të kemi një listë për të gjitha familjet që janë realisht te varfëra dhe ju si zyrë duhet të keni informacion për këto familje.

#### **Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;**

Dokumentacioni duhet të jetë i plotë dhe Drejtoria përkatëse duhet të jetë e përgatitur dhe për pyetje jashtë p/vendimit.Të kemi çdo mbledhje këshili një relacion sqarues me më shumë detaje për çdo familje në nevojë.

#### **Përgjegjësi i Ndhmës Ekonomike z.Rexhep Shaka e merr fjalën;**

Problemi i Ndhmës Ekonomike është vërtetë shumë situatë e vështirë,sa për familjen që na përmendi këshilltarja, ne do ti qëndrojmë afër kësaj familje dhe do ta trajtojmë njësoj siç cdo familje tjetër.

**Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Xhuljeta Boriçi, Arben Hoxha (Këshilltarët e pranishëm).

**2. P/Vendim** “ Për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik”.

**Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.**

Duke lexuar relacionin e p/vendimit duket sikur fituesi është zgjedhur kush do e marri në përdorim këtë truall. Kush është subjekti që e kërkon këtë truall? Çfarë studimi është bërë? Çfarë lloji është trualli që po kërkohet? Nuk e di që si ky këshill bashkiak duhet të votoj këtë p/vendim, ku informacioni që ne kemi para nuk është i plotë. Kush mbanë përgjegjësi për këtë p/vendim dhe pse nuk është Drejtori në mbledhje të mbrojë p/vendimin?

**Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;**

A dëmtohet zona? Çfarë interesi ekonomik ka bashkia ?

Unë jam e mendimit që ky p/vendimet të plotësohet me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe ta lëmë për mbledhjen tjetër.

**Këshilltarja, Xhuljeta Boriçi e merr fjalën;**

Dhe unë të njëjtin mendim kam që ky p/vendim të kalohet në mbledhjen e rradhës.

**Këshilltari Veli Terziu e merr fjalën.**

A janë mbledhur komisionet dhe si është votuar për këtë p/vendim?

**Hidhet në votim sipas propozimeve që ky P/vendim të kalohet në mbledhjen e rradhës;** Nuk miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve 16 vota kundër.

**Shënim:** ( P/Vendimi duhet plotësuar me dokumenta shtesë në momentin që do të kalohet për miratim. Kërkesë me shkrim nga kryeplaku i zones dhe nga Administratori që banorët ja në pro ketij p/vendimi dhe firmat e banorëve, të jetë i plotësuar me hartë dhe kartelë të saktë.)

**3. P/Vendim** “ Për rritje e pakësim plani buxhetor të vitit 2025 të të ardhurave vendore”.

drusor nga subjektet. Për vitin 2025 të ardhurat janë planifikuar në vlerën 220,385 mijë leke.

**Këshilltari Zenel Bahiti e merr fjalën.**

Të gjithë ne e dime se bashkia mbahet me taksa dhe tarifa. Shikoj që keni ndryshuar nja tre zëra. Sponsorizimet janë me vlerën 0, taksa mbi tatimin e të ardhurave personale ka

ndryshuar,taksa e regjistrimit të automjeteve dhe pakësim të planit në sektorin e pyjeve.Kishte dhe një ndryshim tjetër që spo e kuptoja dhe thash të na I sqaroni me zëra.

#### **Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.**

Mos ka ndonjë gabim planifikim zëri tek të ardhurat personale si fillim është miratuar 120 milion dhe mbrapa është shtuar me 30 milion,mos ka ndonjë lapsus nga ana juaj?

#### **Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;**

Meqënëse tha dhe Zeneli që bashkia mbahet me taksa dhe tarifa.Çfarë praktike ndjek kjo Drejtori në qoftë se do I duhet ndihma e Këshillit Bashkiak?

#### **Drejtoresha e të Ardhurave Vendore ,Lindita Shuli e merr fjalën;**

Në zbatim të Ligjit nr 9936 dt.26.06.2008 “ Për menaxhimine sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”,Vkb nr 108 datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025” paraqes për ndryshim të planit buxhetor pasi është e domosdoshme si shtesa të planit në zërin sponsorizime,taksa nga tatimi mbi të ardhurat personale ,shtesë plani në zërin taksë e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve dhe pakësim të planit në zërin tarifë në sektorin e pyjeve dhe tarife e shfrytëzimit të materialit drusor nga subjektet.Për vitin 2025 të ardhurat janë planifikuar në vlerën 220,385 mije leke.

**Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **17 vota pro.**

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Bujar Vreto,Elidjona Bahiti,Fatbardha Qatja,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Arjana Çekrezi,Kujtim Albrahimi,Silvana Hoxha,Veli Terziu,Xhuljeta Boriçi,Arben Hoxha,Habil Biçaku(Këshilltarët e pranishëm).

#### **4. P/Vendim “ Për linjat kryesore dhe oraret e transportit rrethqytetas”**

#### **Këshilltari Ndriçim Doda e merr fjalën.**

Para disa mbledhjeve ne kemi miratuar dhe çmimin e biletës për linjat rrethqytetase ,në ate kohë disa rrugë kanë që të pa afaltuara dhe çmimi ka qënë disi i lartë por tani rrugët janë rregulluar të pothuajse të gjitha dhe çmimi vazhdon i njëjntë. A ka ndonje grup pune që e kontrollon çmimin e biletës në terren?

#### **Drejtoresha e të Ardhurave Vendore ,Lindita Shuli e merr fjalën;**

Rrjeti I linjave rrethqytetëse miratohet çdo tre vjet dhe nuk duhet te cënojë rrjetin e linjave qytetësë dhe ndërqytetëse.Për këtë po paraqesim po paraqesim për miratim në Këshillin Bashkiak,linjat dhe oraret e transportit rrethqytetase.Në lidhje me çmimin e biletës ne kemi një grup pune dhe dalin në terren për kontrollin e çmimit të biletës.

**Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Xhuljeta Boriçi, Arben Hoxha, Habil Biçaku (Këshilltarët e pranishëm).

**5. P/Vendim** “ Për miratimin e ndërhyrjeve në pronë publike për efekt të mbrojtjes së pronave private”.

**Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;**

Po shikoj këto relacionet për të dyja familjet por nuk me pelqen që relacioni të jetë pa bazë ligjore. A ka verifikim në terren nga zyra përkatëse?

**Këshilltari Bujar Vreto e merr fjalën.**

Në fakt problemi i përroit të shesë është një problem i mbartur, aty duhet duhet një ndërhyrje për gjithë rrjedhën e përroit të shesë, aty janë bërë ndërtime të paligjshme, zabtime nga më të ndryshmet. Meqe jemi në këtë temë. Pse luami del nga shtarti I tij? Ku firmat që po ndërtojnë rrugën marrin dhe hedhin inerte vend e pa vend dhe normalisht ngushtimi lumit do sjelli këto pasoja. Çfarë masash ka marrë bashkia në lidhje me këto firma që kanë prishur shtartin e lumit?

**Këshilltarja, Xhuljeta Boriçi e merr fjalën;**

Unë jam pro këtij p/vendimi por e kam pyetjen. A ka bashkia ndonjë informacion çfarë familjesh janë dëmtuar? Kërkojmë një informacion dhe në mbledhjen e ardhëshme ti kemi në dispozicion.

**Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.**

Sot në këtë mbledhje ne duhet të kishim të pranishëm Kryetarin e Shtabit të Emergjencave Civile për të na sqaruar mbi situatën e krijuar në vendin tonë.

**Sekretari i Përgjithshëm Bajram Pishkashi e merr fjalën;**

Në rastin e p/vendimit kemi dy familje që kërkojnë të bëjnë investim për të mbrojtur pronën e tyre. Investimet do të kryejnë me shpenzimet e tyre. Në lidhje e Përroit të Shesë ne kemi një projekt shumë të mirë që e kemi dorëzuar te Emergjencat Civile dhe te Fondi Shqiptarë i Zhvillimit për të na mundësuar fondin.

**Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Xhuljeta Boriçi, Arben Hoxha, Habil Biçaku (Këshilltarët e pranishëm).

**8. Të ndryshme:**

**1. P/Vendim** “ Shtesë fondi për klubin e futbollit Sopot”.

**Sekretari i Përgjithshëm Bajram Pishkashi e merr fjalën;**

Kjo shtesë fondi që Klubi i Sopotit po kërkon rezulton që në dhjetor stafi dhe futbollistat të ngelnin pa paga. Në qoftë se ne i lëmë pa paga çdo gjë e mirë që është krijuar deri tani prishet.

**Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.**

Duhet të ishte i pranishëm dhe Administratori I Klubit për të mbrojtur këtë p/vendim. Po lexoja relacionin dhe shuma totale që ata kërkojnë është 23 milion e pak dhe p/vendimi që ju kërkonte për miratim është në shumën 20 milion leke, po pjesën tjetër ku do ta gjeje,

**Shefi i Klubit I Kf Sopotit, Besnik Kola e merr fjalën;**

Ne si klub këtë vit kemi hyrë me objektiva të qarta për të nxjerr ekipin e sopotit në një kategori më lart, kemi marrë një staf trajnerësh me eksperience dhe shumë lojtare që kanë qënë pjesë e kategorisë së parë dhe superliges por dhe disa lojtare me ngjyre të vendeve të ndryshme, kjo ka sjelle si pasojë rritjen e buxhetit dhe ne kemi kërkuar ndihmën e Këshillit Bashkiak për miratimin e shtimit të fondit prej 20 milion lekësh të përballojmë dhe muajin dhjetor për pagat e futbollistave dhe stafit të ekipit.

**Këshilltari Bujar Vreto e merr fjalën.**

Jemi pro këtij p/vendimi dhe ishalla këtë sezon në një kategori më lartë.

**Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve 16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Xhuljeta Boriçi, Arben Hoxha, Habil Biçaku (Këshilltarët e pranishëm).

**2. P/Vendim** “ Për emërtimin e prishjes së nënobjektit “Palestra e shkollës 9-vjeçare Vilson Blloshmi” Librazhd.

**Sekretari i Përgjithshëm Bajram Pishkashi e merr fjalën;**

Ne kemi fituar projektin për rikostruksionin e shkollës Vilson Blloshmi dhe ndërtimin e palestres së shkolles nga e para, thjeshtë për procedure kemi sjellë pranë jush këtë p/vendim.

**Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve 16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Xhuljeta Boriçi, Arben Hoxha, Habil Biçaku (Këshilltarët e pranishëm).

**3. Prezantimi dhe Diskutimi i Raportit të Performancës të Bashkisë Librazhd, viti 2024**

**Sekretari i Përgjithshëm Bajram Pishkashi e merr fjalën;**

Bashkia Librazhd doli e para në rangë performance kjo e matur nga Pushteti Vendor, kemi fituar një grant dhe do ta sjelli tek ju për investim në të mire komunitetit.

**Këshilltari Bujar Vreto e merr fjalën.**

Më vjen mire për performancën e Bashkisë dhe nuk duhet vetëkënaqësi por duhet punë dhe përkushtim ndaj komunitetit. Na është premtuar para nja dy vitesh që salla e keshillit bashkiak do rregullohet por deri tani asgjë, vini dorë që dhe ne te kemi nje sallë komode.

**Kërkesë:**

Dorheqja e Kryetarit të fshatit Librazhd Katund Z.Urim Mana.

**Kryetari i Këshillit Mitat Biçaku e merr fjalën;**

Do ngrihet grupi punë nga Këshilli Bashkiak dhe bashkë me Administratorin e Njesisë Qender do merrni pjesë për të bërë zgjedhjet e reja. Do njoftoheni nga Sekretari i Këshillit për ditën që do vendoset.

SEKRETAR I KËSHILLIT  
Elson MALLUTA



KRYETARI I KËSHILLIT  
Mitat BICAKU





P/13  
210-1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
NJËSIA ADMINISTRATIVE  
NDIHMJA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

**PROJEKT-VENDIM**

Nr.24 Datë 17.12.2025

**“Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar 6%”  
(Periudha: NËNTOR 2025)**

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” Kreu IV, Vendim Nr. 956, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndhmës Ekonomike”

Nisur sa më lart nga verifikimi i sistemit elektronik i Ndhmës Ekonomike rezulton se janë refuzuar (që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme) 81 Familje, dhe propozohet:

- 1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6%: Gjithsej 81 Familje me një fond: **339,048** lekë. Vlera e ndihmës **272,072** lekë, vlera e energjisë **66,976** lekë
- 2-Të mos përfitojnë për arsye të mos plotësimit të kriterëve nga fondi i kushtëzuar 6% nuk ka familje.
- 3-Familjet përfituese sipas listës bashkëngjitur.
- 4-Ngarkohen për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi Administratorët Shoqërorë të Ndhmës Ekonomike në Njësitë Administrative.
- 5- Ky Projekt-Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së Vendimit

**Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike**

Rexhep Shaka

**KRYETARI I BASHKISË  
MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
NJËSIA ADMINISTRATIVE  
NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

**RELACION**

Nr.24 datë 17.12.2025

**“Mbi Dhënien e Ndhmës Ekonomike nga Fondi i Kushtëzuar 6%”  
(Periudha: NËNTOR 2025)**

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” percaktohet qarte se kush mund ta përfitojë këto ndihme nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok ndihmës ekonomike.

E rëndësishme është që familjet që nuk klasifikohen si përfituese në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike me pikë të pa mjaftueshme të verifikohen saktësisht nga Administratori Shoqërorë i Ndhmës Ekonomike duke e vlersuar nga ana ekonomike, sociale, shoqërore dhe duke pasur parasysh kriteret që janë miratuar në Këshillin Bashkiak ta vlersojë familjen nëse duhet apo jo që të klasifikohet si familje që duhet të përfitojë ndihmë ekonomike nga fondi 6%.

Nisur sa më lartë nga verifikimet në sistem dhe paraprakisht vlersimi social-ekonomik në familje nga Administratori Shoqërorë, nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit 81 Familje dhe propozohet:

1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% Gjithsej 81 familje.

2- Te mos përfitojnë nuk ka familje.

**Njesitë Administrative:**

1. Njësia Administrative Qytet	32 Familje me fond	134,734 lekë
2. Njësia Administrative Hotolisht	11 Familje me fond	52,696 lekë
3. Njësia Administrative Polis	9 Familje me fond	33,505 lekë
4. Njësia Administrative Qendër	18 Familje me fond	72,969 lekë
5. Njësia Administrative Orenjë	11 Familje me fond	45,144 lekë

**Totali si Bashki 81 familje me fond 339,048 lekë.**

## Relacion për Familjet e Refuzuara

- Familjet që nuk janë rekomanduar për tu trajtuar nga fondi 6 % nuk ka.

Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike  
Rexhep Shaka





## FONDI 6%

Periudha: NËNTOR 2025

Bashkia Librazhd

Nr	Emri i Aplikantit	NID	Statusi aplikimit	vlera e		Kompensimi i Energjisë	Totali	Numri anëtarëve
				përlogaritu për fondin 6%				
1	Kujtim Ymerli Polisi	H00409064A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	3	
2	Rabie Sadik Leka	G95628010G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1	
3	Muhamet Qazim Gega	G50501112O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2	
4	Avni Beqir Bogdani	H00106009U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,227	1,288	6,515	3	
5	Xhemile Xhelo Alliu	G75616178K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2	
6	Vera Mehmet Dada	I75404018N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1	
7	Fatbardha Dalip Kurti	G45320047G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1	
8	Eduart Xhevit Pali	I10524158W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,792	1,288	6,080	4	
9	Ymer Xhaferr Kala	G31020023L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049	1,288	4,337	3	
10	Sabri Hajdar Stafa	G71012046N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2	
11	Lutfije Ali Roçi	E25406026F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1	
<b>11</b>	<b>Total Njësia Administrative: Hotolisht</b>			<b>38,528</b>	<b>14,168</b>	<b>52,696</b>	<b>23</b>	
1	Shyqyrije Qazim Shpata	D66211004W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049		3,049	2	
2	Artur Musa Agastra	G10101021O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1	
3	Shyqyrie Belul Billoshmi	G65107079J	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2	
4	Tahire Qamil Balla	G35812017F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1	
5	Vule Kadri Topi	F75710021A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1	
6	Farije Sefedin Topi	G05328025M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1	
7	Qamil Selman Ferra	F80501032B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1	
8	Olsi Nazmi Dosku	H50108018L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1	
9	Fatmira Hysen Gjorga	G15420041E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1	
10	Kujtim Hasan Buzra	F90826008C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2	

11	Jonida Faik Hunçi	I75522027N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
12	Leonard Enver Brasha	J60806018C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
13	Piro Ferit Halili	H70320023A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	3
14	Arjan Mevlut Meta	I20327028C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
15	Nasibe Ismail Hunçi	G45229211O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
16	Artur Isuf Guga	G80721009F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
17	Lulzim Dylber Kazazi	G30612046C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
18	Alma Nexhat Kola	G45703011C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
19	Rajmonda Luan Zylali	I26014010H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940	1,288	7,228	2
20	Bule Myhedin Kojku	H55125015N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	7,920	1,288	9,208	3
21	Mirjana Abdulla Çollaku	G76014110Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
22	Fatmira Beqir Hysa	H70522017S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
23	Qanije Refat Brasha	F95520031H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
24	Xhevahire Haziz Biçaku	G45120093D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
25	Sabije Livan Zyka	F66018008Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,720	1,288	7,008	1
26	Ramazan Tahir Brahja	G10225030V	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
27	Ardi Osman Elezi	I61115008U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
28	Bujar Bajram Bahidi	G80316015M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
29	Albert Refat Brahja	I60413014P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,267		3,267	2
30	Deje Muharem Cohu	G45915009K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
31	Lulzime Nebi Roçi	J55223019R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	3
32	Enkeleda Ferit Braho	J45310022U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	9,900		9,900	4
<b>32</b>	<b>Total Njësia Administrative: Librazhd</b>			<b>112,838</b>	<b>21,896</b>	<b>134,734</b>	<b>51</b>
1	Dashurije Islam Kiçi	F85303158B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
2	Astrit Xhevit Murtini	H00401317G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
3	Ismet Shaip Balliu	F61209003T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	6,752	1,288	8,040	4
4	Nazif Mehmet Qosija	F90730127I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
5	Bashkim Reshit Biba	G70701144N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
6	Nazmi Liman Ruçi	E60228033R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525		1,525	3
7	Kadife Abaz Balliu	G15710021S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
8	Enver Mexhit Kaca	F80502085T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,158	1,288	5,446	3

9	Zanushe Shefqet Haskurti	G76003005L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
10	Nadire Maksut Luka	E85901096E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
11	Hajrije Beqir Lala	E75615085D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
<b>11</b>	<b>Total Njësia Administrative: Orenje</b>			<b>36,128</b>	<b>9,016</b>	<b>45,144</b>	<b>22</b>
1	Sadik Riza Zaimi	G30325115M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
2	Afërdita Rexhep Tanushi	G46125056D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
3	Shyqyri Seit Alimeta	E20222004Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,752		4,752	2
4	Xhevahire Islam Zaimi	G95321059Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
5	Sabrie Sadik Shata	G95605100F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
6	Mexhit Nuredin Stërmugu	F90224131N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
7	Hava Hamit Hasani	G65823039B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
8	Nadire Mustafa Kasa	H26223016N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049		3,049	3
9	Xhevrije Shahin Xhakeri	G65325034C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
<b>9</b>	<b>Total Njësia Administrative: Polis</b>			<b>27,065</b>	<b>6,440</b>	<b>33,505</b>	<b>14</b>
1	Qerim Xhemal Dishani	H00517020G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
2	Suela Federit Shkurti	I65602016S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
3	Ramadan Dalip Allushi	E20103061F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
4	Fatmir Kadri Hoxha	G40320186W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
5	Serme Kamer Qoshku	G65702019R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
6	Isuf Jonuz Seferi	D60826014S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
7	Sanije Shefqet Alija	G65125222I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
8	Mereme Mehmet Çerri	C75607020R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
9	Ymer Tafil Alla	G10625082P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
10	Tefta Asllan Hoxha	G86222012E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
11	Trandafille Sulejman Çela	H05505324G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
12	Suzana Ramazan Almina	J45904016K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	2
13	Xhane Osman Kojku	G65105008W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
14	Sanie Qamil Hoxha	G15614006P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
15	Gani Bajram Faqolli	G40720092D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
16	Sabire Xhemal Shuli	A55716002R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
17	Fiqirete Ymer Rruplli	H85916021Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1

18	Flamur Osman Dosku	G30729006Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
18	Total Njësia Administrative: Qender - LIBRAZH			57,513	15,456	72,969	26
81	Totali Bashkisë			272,072	66,976	339,048	136

Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike

Rexhep Shaka





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD  
SEKTORI I SHERBIMEVE SOCIALE

RELACION  
KESHILLIT BASHKISE LIBRAZHD

Mbi disa kritere te perfitimit te Ndhimes Ekonomike dhe nje informacion mbi Familjet Ekstremisht te Varfera

Librazhd me 18.12.2025

**SKEMA E RE E NDIHMES EKONOMIKE**

Kush mund të përfitojë ndihmën ekonomike:

1. Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;
2. Jetimët të cilët nuk janë në institucione;
3. Prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
4. Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;
5. Viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.
6. Fëmijë të vendosur në shërbimin e kujdestarisë

**Ku aplikohet për ndihmë ekonomike?**

Familjet pa të ardhura, dhe kategoritë e tjera mund të aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike pranë njësisë vendore ku kanë vendbanimin. Kur aplikohet për ndihmën ekonomike? Për të përfituar ndihmë ekonomike kryefamiljari, së bashku me bashkëshorten nga data 1-10 të çdo muaji paraqiten pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/njësitë për të aplikuar për ndihmë ekonomike si familje në nevojë me kopjen e kartës së identitetit të aplikantit dhe kopje të kartave të identitetit të anëtarëve të tjerë të familjes që kanë karta identiteti (për fëmijët certifikata) dhe dokumente të tjera të përcaktuara në aktet nënligjore.

Administratori, në prani të kryefamiljarit, bashkëshortes apo individëve plotëson on-line në sistem aplikimin për ndihmë ekonomike të cilët përmbledhin informacionin për: demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin; llojin e banesës; pasuritë/asetet shtëpiake; të ardhurat nga programet e mbrojtjes sociale. Është me shumë rëndësi që informacioni të jetë i saktë, pasi në rast të kundërt penalizohen familjet për deklaram të rremë. Verifikimi i të dhënave Lista e familjeve aplikante verifikohet automatikisht nga sistemi elektronik me të gjitha institucionet dhe pasi përfundon ky verifikim në lidhje me saktësinë e informacionit merret vendimi për këto familje. Vendimi për trajtimin me ndihmë ekonomike merret brenda muajit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror nëpërmjet formulës së pikëzuar që përfshin parametra të lidhur me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla, si: kushtet e jetesës, zotërimi i pasurive, të ardhurat nga remitancat. Formula e pikëzuar merr parasysh karakteristikat e

ndryshme strukturore të familjeve urbane dhe rurale. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social dërgon Vendimin final së bashku me listën e familjeve fituese me masën e përfitimit dhe familjet jopërfituese me arsyet përkatëse kryetarit të njësisë vendore për të njoftuar të gjithë aplikantët dhe për të bërë ekzekutimin e pagesës. Për të gjitha familjet përfituese është e detyrueshme paraqitja çdo 3 (tre) muaj tek zyra e administratorit shoqëror i cili plotëson deklaratën social-ekonomike dhe e hedh në sistem si dhe verifikon gjendjen shoqërore dhe ekonomike të familjeve në nevojë, kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike. Mosparaqitja një herë në 3 muaj dhe moslejimi i verifikimit social-ekonomik në familje largon familjen nga skema e ndihmës ekonomike. Ku dhe si ankimohet vendimi? Familjet të cilat janë refuzuar se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme kanë të drejtën e riaplikimit në muajt pasardhës dhe gjithashtu ruajnë të drejtën e ankimit në lidhje me vendimin e marrë. Ankimi bëhet me shkrim fillimisht pranë njësisë vendore, e cila është e detyruar të kthejë përgjigje brenda 7 ditëve kalendrike nga marrja e ankesës. Pas ezaurimit të ankimit të njësisë vendore, ka të drejtë të ankimojë te Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror dhe në gjykatë. Për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik, të kryer nga administratori shoqëror, Pagesa e ndihmës ekonomike

**Dokumentacioni që kërkohet për të aplikuar për Ndihmë Ekonomike.**

- Kopjen e kartës së identitetit për të gjithë antarët madhorë të familjes, çertifikate personale për femijet nën 18-vjeç dhe çertifikate familjare.
- **Çertifikata e pronësisë** ose vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive vetë Paluajtshme (Zyra e Kadastrës), ose akti i marrjes në pronësi ose përdorim të tokës, për zonat ku regjistrimi nuk ka përfunduar ende
- Nëse jeton me qera kontratën e qerasë.
- **Vërtetim për ndjekjen e shkollës** për vazhdimin e studimeve të larta deri në 25 vjeç.
- **Vërtetim nga Komisioni Mjekësor Aftësisë për Punë (KMCAP)** për personat me aftësitë kufizuara që janë pjesëtar në çertifikatën familjare.
- Aplikim Hyrje –Dalje jashtë territorit të Shqipërisë për çdo anëtar pjesëtar të çertifikatës familjare që ka kaluar moshën 18-vjeç.

**Shënim:** Për të aplikuar duhet të paraqitet Kryefamiljari, bashkëshortja dhe pjesëtarët e tjerë madhorë të familjes nga data 01 deri 10 të çdo muaji.

Ne lidhje me Familjet Ekstremisht të varfëra duhet të theksojmë që ne fillim se dallimi i tyre nga familjet e varfëra nuk është i lehtë për punonjësin social por tipologjia e tyre zakonisht dallohet nga kushtet e banesës, të ardhurat ekonomike, numri i pjestarëve të familjes në moshë pune apo në moshë pensioni si dhe ajo çka është me e rëndësishme pjestarët e familjes janë në gjendje pune apo janë invalide pune, Persona me aftësi të kufizuara, paratetraplegjike apo të verber.

Për sa me sipër në Bashkinë Librazhd kemi rreth 64 familje të vlersuara si familje ekstremisht të varfëra, të përqendruara 11 familje në Njesinë qytet, 13 në Njesinë Hotolisht, 8 FAMILJE NE Njesinë Polis, 14 familje në Njesinë Qender, 5 familje në Njesinë Lunik, 9 familje në Njesinë Orenje dhe 4 familje në Njesinë Stebleve

Dominanca sociale në këto familje është me shumë se janë persona me aftësi të kufizuara, persona të moshës trete dhe femije jetim në familje kujdestare.

Familje Ekstremisht te varfera jane per tu vlerësuar dhe mund te quhen te tilla edhe ato familje ku ka sunduar dhuna familjare sidomos gra te paisura me urdher mbrojtje ku nga 18 qe kane qene vitin e kaluar 32 gra kemi te paisur me urdher mbrojtje deri me tani.

Ne te gjitha rastet , keto familje jane trajtuar me te gjitha mundesite qe jep ligji qofte me ndihme ekonomike,me pagesen e personit me aftesi te kufizuar,paraplegjikut,te verber, kujdestarit social,statusin e jetimit si dhe pagesen e urdherit te mbrojtjes.

Pervec kesaj nga stafi i sherbimit Social eshte mbajtur parasysh qe ketyre familjeve tu vihet gjithmone ne ndihme me sherbime te tjera shoqerore,tek qendra ditore per femijet me aftesi te kufizuar,tek qendra multifunkionale me specialistet e terapive te ndryshme,tek qendra ditore e moshes se trete me punojs social me vizita dhe sherbime mjeksore falas si dhe herepashere me pako ushqimore kur ka qene mundesia te sjelle nga donator apo shoqata te ndryshme.

**Pergjegjesi i Sherbimeve Sociale**  
**Rexhep Shaka**



# **BASHKIA LIBRAZHD**

**DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE**

# **PAKETA FISKALE**

## **VITI 2026**

91/0  
510  
2



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**BASHKIA LIBRAZHD**  
**DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE**  
**PROJEKT / VENDIM**

NR. \_\_\_\_, DATË \_\_\_\_.\_\_\_\_.2025

**“PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE (TAKSAVE DHE TARIFAVE  
VENDORE), NË BASHKINË LIBRAZHD PËR VITIN 2026”**

**(e përditësuar)**

**Baza Ligore ,mbështetur në:**

- ✓ Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr. 122/2020 , Per disa ndryshime ne ligjin nr 9632, date 30.10.2006 "Per Sistemin e taksave Vendore, të ndryshuar.
- ✓ Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore",shkronja "b" e pikës 1.3 të nenit 9, nenin 35, nenin 36, shkronjën "f" të nenit 54;
- ✓ Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- ✓ Ligjin Nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë";
- ✓ Ligjin Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar;
- ✓ Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar;
- ✓ Ligjin Nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar;
- ✓ Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar;
- ✓ Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- ✓ Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin";
- ✓ Ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë";
- ✓ Ligjin Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", i ndryshuar,
- ✓ Ligjin nr.107/2014 "Për Planifikimin e Territorit" i ndryshuar;
- ✓ Ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative–territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë";
- ✓ Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar;
- ✓ Ligjin nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes vendore";
- ✓ Ligji Nr.10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”.; ndryshuar me Ligjin nr. 71/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”,
- ✓ Ligjin nr.24/2017 "Për Administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit";
- ✓ Ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënproduktet e tyre”

- ✓ Ligjit Nr. 9218, datë 08.04.2004 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, gazit dhe nënproduktet e tyre”,
- ✓ Vendimit Nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar me VKM 344, date 19.04.2017.
- ✓ VKM Nr. 7, date 04.01.2012 “ Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare “ i ndryshuar.
- ✓ Ligji Nr.57/2020” Për Pyjet “ i ndryshuar.
- ✓ Ligji Nr. 9385, datë 4.5.2005“Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, shfuqizuar me Ligjin nr. 20/2020
- ✓ VKM Nr 783, datë 10.11.2022 “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës së mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”.
- ✓ Ligji Nr. 8308 ,datë 18.03.1998 “ Për transportet rrugore “
- ✓ Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar me Nr .559, datë 29.07.2022” Per percaktiminn e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorimte fondit pyjor kullosor , per veprimtari ekonomike , si dhe per prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore .
- ✓ Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- ✓ Ligji Nr. 89/2022 “ Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake ”.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 505, datë 1.8.2007 “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”;
- ✓ Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 132, datë 7.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”;
- ✓ Vendimit Nr. 144 , date 13.02.2020 “Për disa ndryshime ne vendimin Nr.132,datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave”
- ✓ Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 26.07.2023 , Për disa ndryshime ne vendimin VKM Nr.132 ,datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave “ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës .
- ✓ Udhëzimit Nr.1, datë 10.09.2025 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2025.
- ✓ Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 273, datë 16.05.2018 “ Për krijimin e Regjistrit Qendror të Bazës së të dhënave për llogaritjen e Takse Vendore të Pasurisë së Paluajtshme “ Ndërtesë ” ( Kadastra Fiskale ).
- ✓ VKM Nr. 475 , datë 30.07.2021 “ Për bashkëpunimin e Njësive Vendore me Shërbimin Veterinar ”.

- ✓ Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 1 , datë 12.01.2007 “ Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari , tregtare apo shërbimi , ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”
- ✓ Udhëzimit të përbashkët i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe sipërmarrjes të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 8885, datë 07.11.2016 "Për kushtet kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për transportin rrugor turistik.  
Si dhe bashkëpunimi midis drejtorive dhe sektoreve të bashkisë ,**me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, Këshilli Bashkiak** i mbledhur sot më datë \_\_\_/\_\_\_/2025

### VENDOSI:

Të miratojë nivelin e taksave dhe të tarifave vendore , administrimin e tyre në Bashkinë Librazhd për vitin 2026.

- *Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për Bashkinë Librazhd, si më poshtë vijon:*

#### Llojet e taksave subjekt i këtij vendimi :

1- Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme	Pika 1.1 -1.15
2- Parashikime të përbashkëta për Taksën e Pasurisë së Paluajtshme	Pika 2.1 -2.8
3- Taksa mbi ndërtesat	Pika 3.1 - 3.23
4- Taksa mbi tokën bujqësore	Pika 4.1 - 4.8
5- Taksa mbi truallin	Pika 5.1 -5.8
6- Taksa e Biznesit të Vogël	
7- Taksa mbi te ardhurat personale.	
8- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për Pasuritë e Paluajtshme.	
9- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.	
10- Taksa e tabelës & reklame.	
11- Taksa e fjetjes në hotel.	
12- Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve të transportit rrugor.	
13- Taksa e rentes minerale	

## Kapitulli 1.

### A.TAKSAT VENDORE NJËSISA ADMINISTRATIVE LIBRAZHD

#### **1.TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME**

##### **1. PËRKUFIZIME**

**1.1.“Pasuri e paluajtshme”** janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjisllacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

**1.2.“Kadastra fiskale”** është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

**1.3.“Niveli tregues i taksës”** janë nivelet e taksave të parashikuara sipas këtij ligji, si dhe në anekset bashkëlidhur ligjit.

**1.4. “Çmim vlerësues”**, njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar i përcaktuar me këtë metodologji.

**1.5. “Ndarje/nënndarje zonale”**, një rajon territorial brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore me emër dhe numër kadastral unik. Këto ndarje/nënndarje paraqiten në parcella tokësore me kufij të përcaktuar, që i ndajnë ato nga njëra-tjetra.

**1.6. “Ndërtesë”**, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.

**1.7. “Ndërtesë e papërfunduar”**, objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

**1.8. “Njësi pronësore”**, ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”. Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.

**1.9. “Ndarje e njësisë pronësore për banim”**, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.

**1.10. “Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike”**, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.

**1.11. “Përdorues”**, individi, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.

**1.12. “Regjistër qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme”** (Kadastra fiskale), sistemi qendror i bazës së të dhënave, i cili shërben për hedhjen, përpunimin, korrektimin e të dhënave, të cilat lidhen me pasurinë e paluajtshme dhe që shërbejnë për efekt të llogaritjes së shumës së taksës së pasurisë së paluajtshme për t’u paguar nga çdo taksapagues. Ky regjistër ofron informacion për përdoruesit.

**1.13. “Taksapagues”**, çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë” e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat 4 që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

**1.14. “Vlerë e pasurisë”**, vlera aktuale e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore e njohur me dokumente ligjore ose vlera e përcaktuar me një nga metodat e përshkruara në këtë metodologji. Vlera e pasurisë është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.

**1.15. “Veprimtari ekonomike”**, çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet,

gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

## **2.PARASHIKIME TË PËRBASHKËTA PËR TAKSËN MBI PASURINË E PALUAJTSHME**

### **2.1.Subjektet që i nënshtrohen taksës mbi pasurinë e paluajtshme**

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në Ligjin Nr. 9632/2006 parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

### **2.2.Llojet e taksës mbi pasurinë e paluajtshme**

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- a) taksa mbi ndërtesat;
- b) taksa mbi tokën bujqësore.
- c) taksa mbi truallin.

### **2.3.Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme**

Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin "Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

### **2.4.Rregulla të përbashkëta të taksës për pasurinë e paluajtshme**

a) Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë.

b) Në pikën 5 të Ligjit Nr. 9632/2006, i cili parashikon se:

Këshilli bashkiak vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:

- a) personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kritereve të përcaktuara në nivel kombëtar;
- b) taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak në raport me dëmin e shkaktuar, deri në vlerën 75 për qind.

### **2.5.Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave**

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 9632/2006, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive, për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe për ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim

pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të

pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse

shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, këshilli i bashkisë vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë. Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë, i cili konfirmon pagesën e taksave respektive që nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 9632/2006.

### **2.6. Pronat që shtrihen në territorin e më shumë se një njësie të qeverisjes vendore**

Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie, pavarësisht nga vendbanimi i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e Ligjit Nr. 9632/2006.

**2.7. Neni 6 i Ligjit Nr. 9632/2006** parashikon se **“Përjashtohen nga taksat vendore të gjitha subjektet e parashikuara shprehimisht në këtë ligj apo në ligje të tjera të veçanta. Për përjashtimet nga taksat vendore, të cilat aplikohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushteti vendor do të kompensohet për efektet financiare nga Buxheti i Shtetit.”.**

### **2.8. Ankimi**

Neni 7 i Ligjit Nr. 9632/2006 parashikon se **“Ankimi i taksapaguesit në nivel vendor, kundër vendimit apo veprimit të zyrës së taksave, bëhet te struktura vendore e apelimit tatimor, sipas kritereve dhe rregullave të vendosura nga këshilli bashkiak, në përputhje me nenin 4 të Ligjit Nr. 9632/2006. Taksapaguesi ka të drejtë të ankohet në gjykatë kundër vendimit të strukturës së apelimit tatimor në bashki.”.**

## **3. TAKSA MBI NDËRTESET**

### **3.1. Subjektet që i nënshtrohen taksës mbi ndërtesën**

a) Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në Ligjin Nr. 9632/2006 përcaktohen ndryshe.

b) Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit **“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.**

c) Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

### **3.2. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat**

Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

### **3.3. Përjashtimet nga taksa mbi ndërtesat**

a) pronat e shtetit dhe të njësisve të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime

jofitimprurëse;

b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;

c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;

ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;

d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;

dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;

e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";

ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paafitë për punë;

f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

#### **3.4. Baza e taksës mbi ndërtesat**

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

#### **3.5. Shkalla e taksës mbi ndërtesat**

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;

b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;

c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

#### **3.6. Përdorimi i agjentëve të taksave**

Pika 2 e nenit 22/5, të Ligjit Nr. 9632/2006 parashikon se "Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mblidhet nëpërmjet agjentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave."

Taksa e ndërtesës për taksapaguesit familjare në qytet mblidhet nga agjenti tatimor Ujësjellës Kanalizime sipas masës së përfitimit mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesës.

#### **3.7. Përcaktimi i çmimit vlerësues dhe i sipërfaqes së ndërtesës/njesisë pronësore**

Përcaktimi i vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore bazohet mbi prioritetet e vlerësimit, duke ndjekur një radhë të caktuar. Baza e vlerësimit mbështetet

te vetëdeklarimi, si një detyrim për çdo taksapagues, për të vijuar më tej edhe me metodat alternative, nëse vetëdeklarimi nuk bëhet, nuk është i saktë apo nuk disponohen të dhëna të

plota për një vlerësim të drejtë të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore, që duhet të taksohet. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për efekt të përcaktimit të bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë, ndjekin këtë radhë vlerësimi:

a) Vetëdeklarimi

Çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore, që ka në pronësi apo në përdorim.

Vetëdeklarimi bëhet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore apo çdo institucioni të autorizuar nga qeveria apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të marrë dhe për të përpunuar informacionin e vetëdeklarimit të taksapaguesit, për qëllim të zbatimit të legjislacionit përkatës të taksës mbi pasurinë e paluajtshme. Në rast se vlera e vetëdeklaruar nga taksapaguesi rezulton e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmim e vlerësuar, të përcaktuar me këtë metodologji, si vlerë e bazës së taksës do të merret vlera më e lartë. Në fazën fillestare të zbatimit të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, mund të merren në konsideratë dhe të përdoren të dhënat e siguruara nga institucione të autorizuar nga qeveria apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat shërbejnë për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme dhe përcaktimin e bazës së taksës.

b) Përcaktimi i çmimit të vlerësuar dhe i sipërfaqes së ndërtesës, bazuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme të mbajtur nga zyrat vendore (ZVRPP)

Për përcaktimin e bazës së taksës për ndërtesën/njësinë pronësore, si referencë, në këtë rast, do të shërbejë vlera e përcaktuar nga rivlerësimi i pasurisë të regjistruar pranë ZVRPP-ve. Nëse në informacionin e marrë nga ZVRPP-ja konstatohet se për ndërtesën/njësinë pronësore është kryer një transaksion shitblerjeje gjatë 3 viteve të fundit, atëherë si bazë e taksueshme do të merret vlera më e lartë midis transaksionit dhe vlerës të regjistruar në ZVRPP.

c) Përcaktimi i çmimit të vlerësuar sipas çmimeve mesatare të shitblerjes së ndërtesave/njësive pronësore .

Kur vlerësimi sipas pikave 1.1 dhe 1.2 më lart është i pamundur, çmimi i vlerësuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore do të korrespondojë me çmimin mesatar referues të ndërtesave që përdoren për qëllime banimi sipas qyteteve, të përcaktuara në aneksin 1 që i bashkëngjitet dhe është pjesë përbërëse e VKM Nr.132/2018. Për nënkategorizime të ndërtesave, që nuk shërbejnë për banim, sipas qëllimit të përdorimit, zbatohen çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi, të përcaktuara në aneksin 2 që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e VKM Nr.132/2018. Nëse çmimi për metër katror për banesë/njësi pronësore, i vënë në dispozicion nga ZVRPP-ja, dhe çmimet minimale fiskale janë të ndryshme, atëherë merret si çmim vlerësues ai çmim që ka vlerën më të lartë.

### 3.8.Vlera e pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, referuar verifikimeve në terren

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e kuadrit ligjor në fuqi, kryejnë korrektime në regjistrin e bazës së të dhënave. Korrektime të kryhen bazuar në verifikimet periodike në terren për sipërfaqen e ndërtesës/ njësisë pronësore.

Verifikimi në terren shërben edhe për të regjistruar për herë të parë ndërtesa/njësi pronësore ose nënndarje të saj. Në këtë rast, njësitë e vetëqeverisjes vendore kërkojnë informacion nga burime zyrtare, nëse ka, për sipërfaqen e ndërtesës/njësisisë pronësore apo nënndarjen dhe e

krahasojnë me verifikimin e kryer. Nëse nuk sigurojnë informacione lidhur me sipërfaqen e ndërtesave të identifikuara, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vëtvlerësimin e ndërtesës/njesisë pronësore mbi sipërfaqen e verifikuar në terren.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas procedurave të përcaktuara në metodologjinë e parashikuar në VKM Nr. 132/2018, në çdo rast, pasi bëjnë vlerësimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme, hedhin të dhënat në regjistrin e bazës së të dhënave, për efekt të përcaktimit të bazës së taksës dhe llogaritjes së shumës së taksës për t'u paguar nga taksapaguesi.

### **3.9. Sipërfaqja e prezumuar**

Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

- a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;
- b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me Ligjin Nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar. Për ndërtesat e tjera, të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës. Kur gjatë verifikimeve në terren konstatohen dëmtime të ndërtesave për shkaqe të fatkeqësive natyrore (tërmet/zjarr/përmytje etj.), të cilat ndryshojnë vlerën e kësaj pasurie, njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas rastit që i paraqitet, ngre një komision, i cili vlerëson dhe korrekton vlerën e ndërtesës. Vlerësimi bëhet sipas gjendjes fizike në të cilën paraqitet ndërtesa e dëmtuar.

### **3.10. Nënndarja zonale/nënzonale brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore**

Në zbatimin e pikës 3 të nenit 2 të VKM Nr. 132/2018, i cili parashikon se "Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind."

% e shkallës së taksës mbi ndërtesat për banim në qytet dhe në fshat është zbritur -30% .

% e shkallës së taksës mbi ndërtesat për veprimtari ekonomike zonat jashtë qytetit 0.2%

% e shkallës së taksës mbi ndërtesat për veprimtari ekonomike në qytet është zbritur -20% (0.17%

- Për gjashtë njësitë administrative jashtë qytetit , si Hotolisht , Polis , Librazhd Qender , Lunik , Stebleve , Orenjë të cilat iu bashkuan njësisë së qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, do të aplikohet reduktimi i çmimit mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1 të VKM Nr. 132/2018, i ndryshuar.

- % e reduktimit është në masën 35%. përjashtuar zonat rezidenciale.

### **3.11. Vlera e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat e papërfunduara në shkelje të afatit të lejes së ndërtimit.**

Për ndërtesat e pajisura me leje ndërtimi, por që nuk kanë arritur të përfundojnë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi, përcaktimi i bazës së taksueshme bazohet mbi koston e parashikuar të ndërtimit, sipas lejes së ndërtimit të miratuar nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore apo KKT-ja. Në këtë rast, vlera e bazës së taksës së ndërtesës llogaritet për të gjithë ndërtesën, kur është një njësi e vetme dhe e destinuar për një qëllim të vetëm përdorimi, pavarësisht fazës në të cilën gjendet ndërtesa e papërfunduar. Baza e taksës së ndërtesës llogaritet në masën 30 (tridhjetë) për qind të

shkallës së taksës të përcaktuar me ligj, shumëzuar me koston e ndërtimit të parashikuar në lejen e miratuar të ndërtimit. Në rast kur ndërtesa përbëhet nga më shumë se një njësi pronësore, të parashikuara për t'u përdorur për qëllime të ndryshme apo për t'u tjetërsuar në pronësi të më shumë se një pronari/përdoruesi, si bazë e taksës do të shërbejë kostoja e plotë e ndërtimit të të gjitha njësive përbërëse të ndërtesës, pavarësisht fazës në të cilën gjendet e gjithë ndërtesa e papërfunduar. Në qoftë se njësitë e ndërtesës, bazuar në lejen e miratuar të ndërtimit, janë parashikuar për qëllime të ndryshme përdorimi (për shembull, disa për banim dhe disa për veprimtari ekonomike/joekonomike), vlera e pasurisë së paluajtshme për përcaktimin e bazës së taksës së ndërtesës llogaritet në masën 30 (tridhjetë) për qind të shkallës së taksës së përcaktuar me ligj, sipas llojit të përdorimit, shumëzuar me koston e ndërtimit për njësi të ndërtesës.

Në rast se zhvilluesit kanë lidhur kontratë shitjeje për tjetërsimin e pronësisë së ndërtesës së papërfunduar apo të njësive të veçanta të saj, si bazë e vlerësimit të pasurisë së paluajtshme, për efekt të llogaritjes së taksës së ndërtesës, do të shërbejnë kontratat e shitjes. Në qoftë se nga krahasimi rezulton se vlera e kontratave të shitjes është e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmimin vlerësues, atëherë si bazë e taksës përcaktohet vlera më e lartë. Kur nga verifikimi në terren rezulton se ndërtesa apo njësi të veçanta të saj janë vënë në përdorim/shfrytëzim, pavarësisht se ndërtesa në tërësi nuk ka përfunduar, taksa llogaritet e plotë për pjesën në përdorim/shfrytëzim. Në këtë rast, baza e taksueshme llogaritet me koston e ndërtimit për pjesën e papërfunduar dhe me çmimet vlerësuese për pjesët e vëna në përdorim. Për pjesë të ndërtesës të vëna në përdorim, baza e taksës do të jetë e plotë. E njëjta situatë vlen edhe kur nuk është dhënë leja e shfrytëzimit të ndërtesës apo nuk është bërë regjistrimi në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në të gjitha rastet e përmendura në pikën 4 të nenit 2 të VKM Nr. 132/2018, personi që ka për detyrim pagesën e taksës së llogaritur është zhvilluesi. Në rastin kur njësi të veçanta të ndërtesës janë vënë në përdorim dhe taksa paguhet e plotë, paguesi i taksës së llogaritur është përdoruesi.

### **3.12. Llogaritja e shumës së taksës së ndërtesës/ njësisë pronësore**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke përdorur të dhënat e mbledhura për ndërtesën/njësinë pasurore, përcaktojnë bazën e taksës dhe llogarisin shumën e taksës vjetore të ndërtesës për t'u paguar nga çdo taksapagues. Baza e llogaritjes së taksës së ndërtesës është vlera e ndërtesës/njësisë pronësore, përcaktuar me një nga metodat e parashikuara në metodologjinë e parashikuar në VKM Nr.132/2018. Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/ njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, sipas kategorive të ndërtesave, si më poshtë:

- a) 0,05%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

### **3.13. Procedura e mbledhjes së informacionit nga verifikimi në terren**

3.13.1. Verifikimi në terren për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme bëhet, në çdo rast, me urdhër të titullarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, në territorin e së cilës gjendet ndërtesa/njësia pronësore që do të vlerësohet. Urdhri i verifikimit përmban:

- a) të dhënat identifikuese për ndërtesën/njësinë pronësore (adresën, njësinë administrative, vendndodhjen, pronarin/perdoruesin etj.) dhe taksapaguesin (emrin e individit, personin fizik, personin juridik);
- b) qëllimin e kryerjes së procesit të vlerësimit të ndërtesës/njesisë pronësore;
- c) kohën kur do të kryhet verifikimi dhe afatin e mundshëm për procesin e verifikimit;
- ç) emrin/emrat e punonjësve të njësisë së vetë-qeverisjes vendore, që do të kryejnë verifikimin;
- d) datën dhe orën kur punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore do të paraqiten për të kryer verifikimin.

Në qoftë se procesi i verifikimit kërkon plotësimin e formularëve përkatës, këta formularë i dërgohen paraprakisht personit të taksueshëm, së bashku me kopjen e urdhrin për verifikim. Urdhri për njoftimin e kryerjes së procesit të verifikimit dërgohet me postë ose dorazi, kundrejt firmës së personit të taksueshëm, që e ka marrë në dorëzim. Në rast të dërgimit me rrugë postare, konsiderohet se urdhri është marrë në dorëzim pas 10 (dhjetë) ditëve të dorëzimit të tij në zyrën postare.

3.13.2. Paraprakisht, në njoftimin për kryerjen e verifikimit, taksapaguesi duhet të njihet me objektin e procedurës së verifikimit në vend, arsyet për të cilat kërkohet të kryhet ky verifikim, të drejtat e taksapaguesit për të shprehur mendimet, vërejtjet apo kundërshtitë lidhur me procesin e verifikimit të kryer nga punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore në përfundim të këtij procesi, si dhe të informohet se, në rast moskryerjeje të këtij procesi, njësia e vetëqeverisjes vendore ka të drejtën të bëjë vlerësimin me metoda alternative dhe të përcaktojë shumën e taksës vjetore për t'u paguar mbi bazën e këtij vlerësimi.

3.13.3. Në rast të mosgjendjes së personit të taksueshëm në ditën dhe orën e caktuar për kryerjen e procesit të verifikimit, njësia e vetëqeverisjes vendore bën njoftim të dytë dhe, nëse përsëritet e njëjta situatë, punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore bëjnë vlerësimin, duke përdorur metodat alternative të përcaktuara në këtë metodologji.

3.13.4. Në rastin e verifikimit në terren, punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore janë të detyruar të hartojnë aktin e verifikimit, si dhe të shënojnë datën e përfundimit të procesit të verifikimit, emrin, mbiemrin bashkë me firmën në fund të aktit të plotësuar prej tyre.

3.13.5. Punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore janë të detyruar të informojnë taksapaguesin mbi rezultatin e verifikimit, duke e lexuar me zë të qartë dhe në prani të tij përmbajtjen e materialit të shkruar në aktin e verifikimit dhe, në përfundim, të kërkojnë edhe kundërfirmën prej taksapaguesit, për sa përmban akti i verifikimit. Taksapaguesi ka të drejtë të bëjë shënimet e veta përkatëse, nëse dëshiron, lidhur me përmbajtjen e aktit të verifikimit, vërejtjet apo kundërshtitë që ka. Gjithashtu, taksapaguesi, krahas emrit, mbiemrit dhe firmës, vendos dhe datën kur ai ka bërë nënshkrimin e tij.

3.13.6. Kur taksapaguesi pengon punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore të ushtrijnë detyrën e tyre, sipas urdhrin të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore për këtë qëllim, ndaj tyre do të llogaritet taksa e plotë. Në këtë rast, sipërfaqet do të vlerësohen duke përdorur metodat alternative të vlerësimit, siç përcaktohet në këtë metodologji.

3.13.7. Në rastet kur nga verifikimi në terren konstatohen ndërtesa/njësi pronësore për të cilat nuk ka informacion paraprak të plotë ose të pjesshëm, atëherë punonjësi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, me anë të një procesverbali, merr masa për plotësimin e të dhënave identifikuese, si më poshtë:

a) Adresën, koordinatat e vendndodhjes gjeo-grafike, sipërfaqen e ndërtesës/njesisë pronësore;

b) Qëllimin e përdorimit të ndërtesës/njesisë pronësore;

c) Të dhënat identifikuese të siguruara për taksapaguesin;

ç) Emrin/emrat e punonjësve të njësisë së vetëqeverisjes vendore që kanë bërë verifikimin;

d) Datën dhe orën kur punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore kanë bërë verifikimin;

dh) Çdo informacion tjetër të nevojshëm, që shërben për identifikimin e ndërtesës/njesisë pronësore, taksapaguesin dhe përcaktimin e bazës së taksueshme.

Në këtë rast, taksapaguesi duhet të njoftohet për detyrimin e taksës së llogaritur.

3.13.8. Afati kohor i hedhjes së të dhënave të siguruara nga verifikimi në terren në sistemin e bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme nuk duhet të jetë më vonë se 30 ditë kalendrike nga dita e mbajtjes së aktit të verifikimit.

Në çdo rast të ndryshimit të të dhënave në sistemin e bazës së të dhënave, qoftë nga verifikimi në terren, qoftë dhe si rezultat i korrektimit apo i vendimit të strukturës vendore të apelimit apo pas një vendimi të formës së prerë të marrë nga Gjykata Administrative, hedhja e të dhënave nuk duhet të jetë më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendrike nga marrja e vendimit.

3.13.9. Hedhja e të dhënave në sistemin e bazës së të dhënave nuk duhet të dëmtojë funksionalitetin e sistemit. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, nëse konstaton se hedhja e të dhënave mund të dëmtojë sistemin, ndërhyr dhe realizon hedhjen e të dhënave në sistem.

#### **3.14. Verifikimi periodik në terren i pasurive të paluajtshme “ndërtesa”**

Njësia e vetëqeverisjes vendore gëzon të drejtën të bëjë çdo vit verifikime në terren deri në 20 (njëzet) për qind të territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në këtë rast, procesi i verifikimit shërben për verifikimin e ndryshimeve të mundshme në ndërtesat/njesisë pronësore ekzistuese, të cilat ndikojnë në ndryshimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme dhe, për rrjedhojë, edhe të shumës së taksës për t’u paguar. Të tilla ndryshime lidhen me zgjerim të sipërfaqes së ndërtesës/njesisë pronësore, shtesat në kate, përmirësime strukturore, tjetërsim të pronësisë, ndryshim të përdorimit dhe që kërkon ndryshimin e shkallës së taksës, përjashtimin nga taksa apo të humbjes së të drejtës së përjashtimit nga taksa etj. Gjithashtu, ky proces shërben dhe për identifikimin e ndërtesave/njësive pronësore të reja, të pahedhura në sistem.

Në rast të verifikimit të ndërtesave/njësive pronësore që nuk rezultojnë në sistemin qendror të të dhënave, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të realizojë regjistrimin e plotë të tyre, duke plotësuar të gjitha elementet e informacionit të kërkuar nga sistemi. Në të gjitha rastet e mësipërme, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të bëjë me dije subjektin taksapagues për detyrimin e lindur.

#### **3.15. Verifikimi i të dhënave nga ana e nëpunësit përgjegjës në bashki për taksën e pasurisë së paluajtshme ndërtesë.**

Nëpunësi përgjegjës, për taksën mbi ndërtesën në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ka të drejtën dhe detyrimin të bëjë rishikimin dhe verifikimin e të gjithë dokumentacionit të mbledhur gjatë procesit të verifikimit në terren, të aktit të verifikimit të mbajtur, si dhe të konfirmojë saktësinë e tyre. Në rast se dokumentacioni përmban gabime, mangësi apo

pasaktësi, ai u kërkoi punonjësit, që kanë plotësuar dokumentacionin, pishikimin e tij, si dhe, nëse është e nevojshme, përsëritjen e procedurës së verifikimit.

### **3.16. Korrigjimi i të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale dhe çmimet përkatëse**

Taksapaguesi, në çdo kohë, kur gjykon se vlerësimi i pasurisë së tij të paluajtshme ndërtesë, objekt taksimi, është jo i saktë, ka të drejtë të kërkojë korrigjimin e detyrimit.

Taksapaguesi, pas marrjes së njoftimit të detyrimit për taksën e pasurisë, kur nuk është dakord me këtë vlerësim, ka të drejtë të bëjë kërkesë për korrigjimin e vlerës:

a) në zyrën tatimore vendore të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme “ndërtesë”, të shoqëruar dhe me dokumentacionin justifikues; ose

b) në zyrën e agjentit të mbledhjes së taksës, për rastet kur në këto zyra, shërbimi i korrigjimit ofrohet nga njësi e vetëqeverisjes vendore me punonjësit e saj.

E drejta ose jo e korrigjimit të vlerës përfundim-tare të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë” do të përcaktohet pas shqyrtimit të ankimimit nga struktura e autorizuar pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe marrjes së një vendimi përfundimtar.

Zyra tatimore vendore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, bën shqyrtimin e kërkesës së subjektit në lidhje me marrjen ose jo në konsideratë të saj, bën korrigjimin, nëse vlerësimi fillestar ka pasur gabime dhe i kthen përgjigje me shkrim taksapaguesit.

### **3.17. Ankimimi administrativ dhe ankimimi gjyqësor**

Nëse edhe pas marrjes së përgjigjes në lidhje me të drejtën e korrigjimit, taksapaguesi nuk bie dakord me qëndrimin e zyrës tatimore pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, ai ka të drejtë që, bazuar në nenin 7, “Ankimimi”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, t’i drejtohet strukturës vendore të apelimit tatimor të ngritur për këtë qëllim pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore. Struktura vendore e apelimit tatimor jep qëndrimin e saj brenda afatit ligjor të parashikuar në legjislacionin tatimor.

Nëse taksapaguesi përsëri nuk bie dakord me vendimin e dhënë nga struktura vendore e apelimit tatimor, i drejtohet Gjykatës Administrative. Vendimi i Gjykatës Administrative konsiderohet përfundimtar dhe do të shërbejë për korrektimin e vlerës së bazës së taksueshme, për rrjedhojë, edhe të shumës së taksës për t’u paguar nga taksapaguesi.

### **3.18. Lindja e detyrimit për taksën e pasurisë ndërtesë/njësi pronësore pas konstatimit të ndryshimeve nga verifikimi në terren .**

Në rastet kur nga verifikimet në terren rezulton ndryshim në vlerën e bazës së taksës, shuma e taksës së llogaritur reflektohet në shumën e taksës për t’u paguar, nisur nga dita e konstatimit në terren të mbajtur në aktin e verifikimit përkatës. Në çdo rast, akti i verifikimit duhet të jetë i firmosur nga taksapaguesi, të cilit i është konstatuar ky ndryshim gjatë verifikimit të kryer.

### **3.19. Ndryshimi i përdorimit të ndërtesës nga sa është regjistruar në sistemin e bazës së të dhënave**

Në qoftë se njësitë e vetëqeverisjes vendore konstatojnë ndryshime të përdorimit të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore apo pjesë të njësisë pronësore, të cilat sjellin, për pasojë, edhe ndryshimin e vlerës së bazës së taksës, për rrjedhojë, edhe të shumës së taksës për t’u paguar nga taksapaguesi, shuma e taksës për t’u paguar, pas ndryshimit të konstatuar për pjesën e mbetur të vitit, korrigjohet dhe mbledhja e taksës bëhet për shumën faktike të

taksës së korigjuar. Ndryshimet për detyrimin për t'u paguar fillojnë nga data e konstatimit të mbajtur në aktin e verifikimit.

Në çdo rast, akti i verifikimit duhet të jetë i firmosur nga taksapaguesi, të cilit i është konstatuar ky ndryshim gjatë verifikimit të kryer.

### 3.20. Nënkategori specifike ndërtesash dhe qëllimi i përdorimit

Nënkategorizimi i ndërtesave/njësi pronësore që nuk përdoren për banim, sipas qëllimit të përdorimit dhe të shfrytëzimit të tyre, përcaktohen në aneksin 2, bashkëngjitur VKM Nr. 132/2018. Nënkategoritë e ndërtesave/njësi pronësore, që shfrytëzohen për banim/strehim, jepen si më poshtë:

1. Ndërtesa e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet, banesat dhe ndërtesat e ngjashme;
2. Garazhet e mbyllura;
3. Bodrumet;
4. Çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nën tokë, që nuk përdoret apo shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit.

### 3.21. Përlllogaritja dhe pagesa e detyrimit të taksës mbi ndërtesat

- Struktura përgjegjëse për llogaritjen e taksës mbi ndërtesat për banim dhe njësi ekonomike është Sektori i Taksave, Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

- afatin kohor të gjenerimit të faturës për taksën mbi ndërtesat është 30.05.2026.

- afatin kohor të pagesës së taksës mbi ndërtesat është 30.11.2026 për biznesin person fizik dhe 30.09.2026 për biznesin person juridik, për taksapaguesit familjarë deri 31.12.2026.

- vendin e pagesës së taksës mbi ndërtesat është pranë arkës së Bashkisë, në postë dhe në bankat e nivelit të dytë.

### 3.22. Llogaritja e taksës mbi ndërtesat

Sipas Ligjit Nr.115/2014 janë 7 njësi administrative të Bashkisë Librazhd.

Çmimi mesatar referues sipas VKM Nr. 132/2018 për Bashkinë Librazhd është 44,000 lekë.

#### **TABELA NR 1**

VLERA E TAKSËS PËR NDËRTESSAT QË PËRDOREN, SHFRYTËZOHEN PËR BANIM				
Nënkategori specifike ndërtesash dhe qëllimi i përdorimit	Njësitë Administrative sipas Ligjit Nr.115/2014 *	Çmimi Mesatar Referues sipas i parashikuar për në Aneksin 1 të VKM Nr. 132/2018 (P mesatar referues)	Shkalla e taksës për ndërtesa që përdoren, shfrytëzohen për banim %	Vlera e taksës për ndërtesa që përdoren, shfrytëzohen për banim 15.4 leke ne qytet / lek m2
Ndërtesa e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet, banesat dhe ndërtesat e ngjashme	Librazhd Qytet	44000	0.035	15.4
	Hotolisht	28600	0.035	10
	Lunik	28600	0.035	10
	Polis	28600	0.035	10
	Stebleve	28600	0.035	10
	Librazhd Qender	28600	0.035	10
	Orenje	28600	0.035	10

Garazhet e mbyllura	Librazhd Qytet	44000	0.035	15.4
	Hotolisht	28600	0.035	10
	Lunik	28600	0.035	10
	Stebleve	28600	0.035	10
	Polis	28600	0.035	10
	Librazhd Qender	28600	0.035	10
	Orenje	28600	0.035	10
Bodrumet	Librazhd Qytet	44000	0.035	15.4
	Hotolisht	28600	0.035	10
	Lunik	28600	0.035	10
	Stebleve	28600	0.035	10
	Polis	28600	0.035	10
	Librazhd Qender	28600	0.035	10
	Orenje	28600	0.035	10
Çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nën tokë, që nuk përdoret apo shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit	Librazhd Qytet	44000	0.035	15.4
	Hotolisht	28600	0.035	10
	Lunik	28600	0.035	10
	Polis	28600	0.035	10
	Stebleve	28600	0.035	10
	Librazhd Qender	28600	0.035	10
	Orenje	28600	0.035	10

Për banesat shkalla e taksës është ulur 30% si në njesine administrative në qytet ashtu dhe në njesite të tjera fshat ose njesite që janë bashkuar sipas Ligjit 115/2014.

Për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit, të cilat iu bashkuan njësitëve të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, çmimin mesatar referues është reduktuar në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

- d) Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.

**TABELA NR.2**

VLERA E TAKSËS PËR NDËRTESET QË PËRDOREN, SHFRYTËZOHEN PËR VEPRIMTARI EKONOMIKE				
ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQË NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR NDËRTIME DHE AMBIENTE JOBANIMI	Njësitë Administrative sipas Ligjit Nr.115/2014	Çmimi Mesatar Referues sipas i parashikuar për në Aneksin 2 të VKM Nr. 132/2018 (P mesatar referues) Lekë	Shkalla e taksës për ndërtesa që përdoren, shfrytëzohen për veprimtari ekonomike /%	Vlera e taksës për ndërtesa që përdoren, shfrytëzohen për veprimtari ekonomike /Lekë
Çmimi për metër katror	Librazhd Qytet	66000	0.17	112.2

<p>sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike</p> <p>tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) here më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë</p>	Hotolisht	42900	0.2	85.8
	Lunik	42900	0.2	85.8
	Stebleve	42900	0.2	85.8
	Polis	42900	0.2	85.8
	Librazhd Qender	42900	0.2	85.8
	Orenje	42900	0.2	85.8
	<p>Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve</p>	Librazhd Qytet	30800	0.17
Hotolisht		20020	0.2	40
Lunik		20020	0.2	40
Stebleve		20020	0.2	40
Polis		20020	0.2	40
Librazhd Qender		20020	0.2	40
Orenje		20020	0.2	40
<p>Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit</p>	Librazhd Qytet	13200	0.17	22.44
	Hotolisht	8580	0.2	17.16
	Lunik	8580	0.2	17.16
	Stebleve	8580	0.2	17.16
	Polis	8580	0.2	17.16
	Librazhd Qender	8580	0.2	17.16
	Orenje	8580	0.2	17.16
<p>Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshijë ato të</p>	Librazhd Qytet	22000	0.17	37.4
	Hotolisht	14300	0.2	28.6
	Lunik	14300	0.2	28.6

njësive të tregimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse. Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura	Stebleve	14300	0.2	28.6
	Polis	14300	0.2	28.6
	Librazhd Qender	14300	0.2	28.6
	Orenje	14300	0.2	28.6
Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor	Librazhd Qytet	13200	0.17	22.44
	Hotolisht	8580	0.2	17.16
	Lunik	8580	0.2	17.16
	Stebleve	8580	0.2	17.16
	Polis	8580	0.2	17.16
	Librazhd Qender	8580	0.2	17.16
	Orenje	8580	0.2	17.16
Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indeksohet me koeficientin 0.2 (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK	Librazhd Qytet	8800	0.17	14.9
	Hotolisht	5720	0.2	11.44
	Lunik	5720	0.2	11.44
	Stebleve	5720	0.2	11.44
	Polis	5720	0.2	11.44
	Librazhd Qender	5720	0.2	11.44
	Orenje	5720	0.2	11.44

Për ndërtesat në njësitë administrative jashtë qytetit, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, çmimin mesatar referues është reduktuar në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

Vetëm në njësinë administrative qytet është ulur shkalla e taksës 15 %.

### 3.23. Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:

- mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;
- përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);

c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën;

ç) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimin të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj;

d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

#### 4. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

4.1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi, në përdorim të taksapaguesit.

4.2. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.

4.3. Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 1, Ligjit Nr. 9632/2006,

Aneksi 1

Nr	Klasifikimi sipas kategorise se tokes	Lekë/ hektar në vit
1	I	2,800
2	II	2,100
3	III	1,400
4	IV	1,350
5	V	1,250
6	VI	1,200
7	VII-X	1,100

4.4. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

4.5. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës sipas Ligjit Nr. 9632/2006.

4.6. Përfshihen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

4.7. Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

4.8. -Struktura përgjegjëse për llogaritjen e taksës mbi tokën bujqësore janë specialistet e njesive administrative .

-Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor .

-Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, certifikatës së regjistrimit të tokës.

-afati kohor i gjenerimit të faturës për taksën mbi tokën bujqësore është 31.05.2026

-afati kohor i pagesës së taksës mbi tokën bujqësore është 31.12.2026

- vendi i pagesës së taksës mbi tokën bujqësore është pranë njesive administrative , postes , Bankave të Nivelit të dytë.

#### 5. TAKSA MBI TRUALLIN

5.1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

5.2. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

5.3. Kategoritë minimale të truallit jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet Ligjit Nr. 9632/2006.

5.4. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror.

5.5. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

5.6. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2, të Ligjit Nr. 9632/2006.

5.7. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Aneksi 2

Nr	Taksa e Truallit	Njësia	Vlera e taksës në lekë/ m <sup>2</sup> vit
1	Vlera e taksës së truallit për qëllime banimi nga individët .	lekë/m <sup>2</sup> /vit	0.28
2	Vlera e taksës së truallit për qëllime biznesi.	lekë/m <sup>2</sup> /vit	15

5.8.-Struktura përgjegjëse për llogaritjen e taksës mbi truallin është Drejtoria e të Ardhurave Vendore , specialistët e njësive administrative .

-Afati kohor i gjenerimit të faturës për taksën mbi truallin është 31.05.2026 .

-Afati kohor i pagesës së taksës mbi truallin brenda datës 30 Shtator të vitit fiskal për biznesin e madh , dhe 30 Nëntor të vitit fiskal për biznesin e vogël , pë familjaret 31.12.2026.

-Vendi i pagesës së taksës mbi truallin, paguhet pranë sporteve të postës, bankave të nivelit të dytë , arkës së njësive e tjera administrative .

## **6. Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël**

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8,000,000 ( tetëmijlon) lekë , u nënshtrohet detyrimeve të parashikuara.

Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure , të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë , pa u kufizuar vetëm në to; të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve , të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat , të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme.

### **Shkalla Tatimore .**

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).

### **Parapagimi**

1. Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës

tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare,

këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

2. Në rast se aktiviteti i biznesit hapet, mbyllet apo pezullohet gjatë vitit fiskal, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është proporcional me kohën e zhvillimit të aktivitetit dhe llogaritet në bazë të vetëdeklarimit të tatimpaguesit. Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë gjatë vitit, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin llogaritet në bazë të qarkullimit dhe të fitimit të tatueshëm, të parashikuar nga vetë tatimpaguesi, për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik.

3. Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, gjatë periudhës tatimore, vërteton se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, të periudhës paraardhëse, organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të parashikuara me udhëzim të Ministrit të Financave.

3/1. Nëse organet tatimore vlerësojnë dhe kanë të dhëna se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për periudhën vijuese tatimore, do të tejkalojë me më tepër se 10 për qind tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e periudhës së mëparshme tatimore, ato mund të rregullojnë në rritje parapagimet, në përputhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e vlerësuar prej tyre.

4. Pagesat e kësteve të tatimit kryhen te bankat e nivelit të dytë dhe Postës Shqiptare për llogari të administratës tatimore, brenda datave 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të çdo viti. Me kryerjen e pagesës dhe marrjen e konfirmimit bankar të kryerjes së pagesës, tatimpaguesi shkon te zyrat e shërbimit tatimpagues tatimor dhe, kundrejt paraqitjes së dokumentit bankar të pagesës, merr "Pullën e tatimit" të këstit, për të cilin ka bërë pagesën. Dizenjot dhe elementet e pullës caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Tatimpaguesi e vendos pullën e tatimit lart certifikatës së regjistrimit në QKR për të lehtësuar ushtrimin e kontrollit vizual nga organet kompetente. Këto dokumente prodhohen nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë dhe shpenzimet përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. "Pulla e tatimit" duhet të përmbajë elemente të sigurisë së lartë për të shmangur falsifikimin e tyre.

5. Drejtoritë rajonale tatimore bëjnë regjistrimin e arkëtimit tremujor të tatimit, që shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së tatimit me zyrat e tatimeve të bashkive. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë ose në mënyrë elektronike, forma dhe përmbajtja e të cilit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

#### **Deklarimi**

Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore.

#### **Administrimi i tatimit**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore është e ngarkuar me vlerësimin dhe kontrollimin e tatimpaguesve, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata rajonale tatimore krijon një regjistër të veçantë mbi biznesin e vogël, në bazë të të dhënave që merr nga bashkitë. Ky regjistër do të përditësohet me hapjen e biznesve të reja.

#### **Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njësisve të qeverisjes vendore dhe në buxhetin e shtetit dhe komisioni i agjentit tatimor.**

Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet.

Administrata Tatimore Qendrore, për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësisve të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore. Komisioni kalon në llogari të Buxhetit të Shtetit, në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave dytësore, të krijuara në institucionet buxhetore dhe për mbulimin e kostove të "Pullave të tatimit".

#### **Bashkëpunimi**

1. Drejtoria Rajonale Tatimore njofton Bashkinë jo më pak se një herë në gjashtë muaj për punën e bërë për nivelin e vjeljes së këtij tatimi.
2. Bashkitë, kur e gjykojnë të nevojshme, i kërkojnë organit tatimor kryerjen e veprimeve për plotësimin e detyrave për administrimin e tatimit dhe derdhen në favor të saj, sipas afatit ligjor të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar i fitimit mbi biznesin e vogël.

#### **7. Taksa mbi të ardhurat personale**

Në zbatim të gërmës ç, pika 2 e nenit 25 të ligjit nr 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore" njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përfituese të 2% nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP) që realizohen në juridiksionin e tyre. Nga të ardhurat personale 2 % e të ardhurave xhirohen nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave për llogari të Bashkisë .

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera.

Baza e taksës: Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritet mbi të ardhurat e individëve. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përfitojnë si taksë të ndarë, 2 (dy) për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Drejtoria Rajonale të Tatimeve është përgjegjëse për arkëtimin. Për vitin 2026 Tatimi mbi të Ardhurat Personale u shpërnda në bazë të numrit të popullsisë së Bashkive për arsye se nuk është gjetur akoma mekanizimi i duhur teknik sipas juridiksionit të punonjësve ku mbliidhet tatimi. Për efekte të përlllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale do të merren si të ardhura të tatueshme, të ardhurat e percaktuara në nenin 8 të Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998.

#### **8. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.**

**Baza e taksës** mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre.

## Niveli i taksës: Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat

dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Bazuar ne ligjin Nr.9632 date 30.10.2002 i ndryshuar me Ligjin Nr. 95, datë 03.12.2018 Aneksi 3 ,Tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme.

**Nivelet e taksës së kalimit të pronësisë mbi ndërtesat janë:**

Aneksi 3

Nr	Kategoritë e ndërtesave	Lekë/m <sup>2</sup>
1	Ndërtesa banimi	100
2	Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime, përfshi dhe zyra.	300
3	Ndërtesa të tjera.	200

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse** është Agjensia Shtetërore e Kadastrës e cila në rolin e agentit tatimor, përfiton 3%( tre për qind)të shumës së arkëtuar dhe diferencën prej 97 % e derdhit për llogaritë buxhetit përkatës të bashkisë, në territorine së cilës ndodhet pasuria jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

### **Përfashtime:**

Përfashtohen nga pagimi i taksës e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme :

- Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore .
- Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”.
- Subjektet, që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtëpërdrejtë janë :
  - Institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
  - Bashkësitë fetare ose organizatat Jo fitimprurese , kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi.Në këto raste dhuruesi ,pasi ka marrë vërtetim nga Këshilli Bashkiak për përfashtimin nga taksa , bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agentit të taksave.
  - Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës,pavarsisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

### **9.Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja**

**Baza e taksës:** Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënie e lejes së ndërtimit. Ligji nr 107/2014 date 30.07.2014”Per planifikimin e dhe kontrollin teritorit.

**Niveli i taksës:** shprehet në përqindje e vlerës së investimit dhe është në kufijtë 1 deri ne 6 % të kësaj vlere. Detyrimi për taksën i takon investitorit.E ardhura nga taksa per cdo rast mblidhet nga organi qe leshon lejen e ndertimit dhe arketohet per llogari te Bashkise qe mbulon teritorin ku do te behet investimi.

Kjo taksë zbatohet për zhvillimet që kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritjet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, ose vlera në leke e

çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe të gjitha tarifat e tjera, paguhet para dorëzimit të dokumentit të lejës së ndërtimit.

### **9.1. Taksa e ndikimit në Infrastrukturë .**

Zbatimi i Nenit 27 i Ligjit 9632 /2006,

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri në 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.

Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njërive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave.

3. Në rastin e ndërtimeve, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe: a), b), c), dhe d).

4. Këshilli bashkiak miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.

5. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

6. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

7. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtur të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".

8. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

**Niveli i taksës** së ndikimit në infrastrukturë sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë:

Nr	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË	Në % mbi vlerën e investimit
----	------------------------------------	------------------------------

9.1.1	Ndertesat te reja ne funksion te banimit deri ne 2-kate per strehim dhe bodrume.	1% e vleres se investimit
9.1.2	Ndertesat publike(zyra,shkola,qendra shendetesore)	1% e vleres se investimit
9.1.3	Rikonstrukcion te cdo lloji ndertese ekzistuese	2% te vleres se investimit
9.1.4	Ndërtime për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi nga shoqëri ndërtimi të cilat nuk destinohen për përdorim në turizëm ,industri apo publik	6% e cmimit të shitjes/m <sup>2</sup>
9.1.5	Për ndërtesat që janë në process legalizimi kur subjekti posedon vetëm një objekt.	0.5% mbi vlerën e investimit
9.1.6	Ndërtesat e tjera të cdo lloji që nuk citohen më lart	3% mbi vlerën e investimit
9.1.7	Për ndërtesat që janë në process legalizimi,kur subjekti posedon më shumë se një objekt,për objektin jo preferencial.	Sipas masës së përcaktuar në pikat më lart sipas llojit të objektit
9.1.8	Projektet e infrastrukturës për ndërtimin e rrugëve kombëtare,tunele ,digave , ndërtimit të infrastrukturës në enrgji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	0.1 % e vlerës por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar.
9.1.9	Ndërtimet për parkimet e mbuluara dhe bodrumeve, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi;	4 % e çmimit të shitjes për m2
9.1.10	Ndërtimet e realizuara me deklaratë paraprake punimesh;	1% e vlerës së investimit
9.1.11	Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive.	0.5% e vlerës së investimit

## 9.2 APLIKIMET

Nr	Lloji Lejes	Lekë	Shënim
9.2.1	Leje zhvillimi	10,000	
9.2.2	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	10,000	
9.2.3	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	20,000	
9.2.4	Leje për ndryshimin e funksionit	10,000	
9.2.5	Çertifikatë përdorimi	10,000	
9.2.6	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2	0.5%	e vlerës së preventivit
9.2.7	Leje ndërtimi për prishje ndërtimi ekzistues	5,000	
9.2.8	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2	0.5%	e vlerës së preventivit
9.2.9	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	10,000	

9.2.10	Leje ndërtimi për rikonstrukcion pa ndryshim funksioni	10,000	
9.2.11	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	5,000	
9.2.11	Njoftim për fillimin e punimeve	0	
9.2.12	Njoftim për raportin e mbikqyrjes	0	
9.2.13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	10,000	
9.2.14	Leje ndërtimi për rikonstrukcion me ndryshim funksioni	15,000	
9.2.15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	0.5%	e vlerës së preventivit
9.2.16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	0.5%	e vlerës së preventivit
9.2.17	Njoftim për raportin e kolaudimit	0	
9.2.18	Leje Infrastruktura	5,000	
9.2.19	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup> e pershpejtuar	1%	e vlerës së preventivit
9.2.20	Leje për prishje ndërtimi ekzistues e pershpejtuar	50,000	
9.2.21	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup> e pershpejtuar	1%	e vlerës së preventivit
9.2.22	Leje ndërtimi për rikonstrukcion pa ndryshim funksioni e pershpejtuar	50,000	
9.2.23	Leje ndërtimi për rikonstrukcion me ndryshim funksioni e pershpejtuar	70,000	
9.2.24	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup> e pershpejtuar	1%	e vlerës së preventivit
9.2.25	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup> e pershpejtuar	1%	e vlerës së preventivit
9.2.26	Leje për ndërtime të reja në zonat e dëmtuara dhe në zonat e reja për zhvillim	0	
9.2.27	Leje rindërtimi, rikonstrukcioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar me shtim apo ndryshim vëllimi	0	
9.2.28	Leje rindërtimi, rikonstrukcioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar, pa shtim apo ndryshim vëllimi	5,000	
9.2.29	Leje për prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore	0	
9.2.30	Leje ndërtimi apo rikonstrukcioni të infrastrukturës publike apo kritike në zonat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore dhe në zonat e reja për zhvillim	0	
9.2.31	Leje zhvillimi në rastet e fatkeqsisë natyrore	0	

9.2.32	<b>Punime qe nuk kerkojne pajisje me leje ndertimi dhe deklarate</b> paraprake punimesh	5,000	
9.2.33	Tarife per prishje objekti leke / m2	100	

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife e ka Sektori i Urbanistikës ,Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Pagesa do të kryhet pranë arkës të Bashkise ose Bankave të Nivelit të Dytë.

#### **10.Taksa e tabelës dhe reklamës.**

**Baza e taksës:** Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.

Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike,juridike,private e shtetërore,vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkise Librazhd.

**Niveli i taksës** për Bashkine Librazhd është si mëposhtë vijon:

Nr	Llojet e tabelave	Njesia matese	Niveli i taksës
10.1	<b>Tabelë për qëllime identifikimi, te trupezuar ose jo brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe qe nuk perdoret per te reklamuar veprimtarite e te treteve (ku shenohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit).</b>		
10.1.1	<b>Deri ne 2 m<sup>2</sup></b>	lek/m <sup>2</sup> /vit	0
10.1.2	<b>Mbi 2 m<sup>2</sup> deri ne 10 m<sup>2</sup></b>		
	E thjeshte( pa ndricim)	lek/m <sup>2</sup> /vit	7,000
	Me ndricim te thjeshte	lek/m <sup>2</sup> /vit	11,500
	Elektronike	lek/m <sup>2</sup> /vit	15,000
10.1.3	<b>Mbi 10 m<sup>2</sup> deri ne 20 m<sup>2</sup></b>		
	E thjeshte( pa ndricim)	lek/m <sup>2</sup> /vit	5,950
	Me ndricim te thjeshte	lek/m <sup>2</sup> /vit	9,775
	Elektronike	lek/m <sup>2</sup> /vit	12,750
10.1.4	<b>Mbi 20 m<sup>2</sup> deri ne 40 m<sup>2</sup></b>		
	E thjeshte( pa ndricim)	lek/m <sup>2</sup> /vit	3,850
	Me ndricim te thjeshte	lek/m <sup>2</sup> /vit	6,325
	Elektronike	lek/m <sup>2</sup> /vit	8,250
10.1.5	<b>Mbi 40 m<sup>2</sup></b>		
	E thjeshte( pa ndricim)	lek/m <sup>2</sup> /vit	2,800

	Me ndricim te thjeshte	lek/m <sup>2</sup> /vit	4,600
	Elektronike	lek/m <sup>2</sup> /vit	6,000
<b>10.2</b>	<b>Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim.</b>		
10.2.1	Tabela identifikuese	lek/m <sup>2</sup> /vit	120
<b>10.3</b>	<b>Tabelë për qëllime reklamimi të lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m<sup>2</sup></b>		
10.3.1	E thjeshtë ( me/pa ndricim)	lek/m <sup>2</sup> /vit	13,500
10.3.2	Elektronike	lek/m <sup>2</sup> /vit	27,000
<b>10.4</b>	<b>Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura,panaire,spektakle,stenda reklamuese ,banderola etj.</b>		
10.4.1	Të të gjitha llojeve dhe përmasave	lek/m <sup>2</sup> /vit	1,000

Afatet e pagesës: Derdhja e të ardhurave për këtë taksë në favor të Bashkisë.

1. Për subjektet detyrimi paguhet brenda datës 30 Shtator 2026 per biznesin e madh dhe 30 Nëntor 2026 biznesin e vogël.Për subjektet e reja mbas afateve te percaktuara me lart ,kane afatin 30 dite mbas momentit te rregjistrimit ne rregjistrin e taksapaguesve te Bashkisë .
2. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji / data që subjekti regjistrohet pranë QKB dhe paguhet sipas afateve te pikes 1.
3. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKB.
4. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë.
5. Për "kategorinë 4"10.4 detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë dhe paguhet menjëherë.

**Sanksione:** Tatimpaguesi,i cili nuk arrin që,brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimore të kontributit,detyrohet të paguajë një gjobë,të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë,gjatë së cilës pagesa nuk është kryer.Në asnjë rast,kamata nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

**Struktura e ngarkuar për miratim** për të vendosur table identifikuese/ reklamuese eshte Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te teritorit prane Bashkise Librazhd , bazuar kjo ne kërkesën e vete subjektit qe do te vendose table identifikuese / reklamuese.

**Struktura e ngarkuar per identifikim** , matjen dhe perllogaritjen e kesaj takes eshte Sektori i Kontrollit Territorit.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen** e kësaj takse është Drejtoria e të Ardhurave Vendore, pranë Bashkisë Librazhd .

**Struktura e ngarkuar për penalitetet** përmos pajisje me lejë për vendosje table reklamuese është Policia Bashkiake, Sektori i Kontrollit Territorit .

Për kategorinë tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike:

Struktura/drejtoria përgjegjëse për kontrollin e zhvillimit të territorit ngarkohet për shqyrtimin e kërkesës së subjektit, si dhe për hartimin e dokumentacionit të plotë të marrjes së lejes për vendosjen e reklamave dhe përcaktimin e sipërfaqeve objekt taksimi. Kjo drejtori njofton në mënyrë periodike Sektori i Taksave dhe i Tarifave Vendore në lidhje me të gjitha ndryshimet në sipërfaqe (shitesa apo pakësime) që janë objekt i kësaj takse.

**Afati i njoftimit tatimpaguesve:** 31.05.2026.

### **11.Taksa e fjetjes në hotel.**

**Përkufizimi:** Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a)“Bujtinë”; b)“Fjetinë” (Hostel); c)“Kamping”; ç)“Hotel”; d)“Motel”; dh)“Resort”; e)“Qendër kurative”;

**Baza e taksës:** Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, çmimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë.

Janë subjekt i taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

**Niveli i taksës** është si më poshtë:

Nr	Kategoritë e Hoteleve	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel
11.1	Hotele me 4 ose 5 yje	lekë/natë qëndrimi	105
11.2	Bujtinë, fjetin, motel dhe cdo njësi tjetere komoduese sipas ligjit për Turizmin, për cdo natë fjetje sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin .	lekë/natë qëndrimi	35

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridikionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës se caktuar për pagesë sipas kategorise së biznesit.

**Struktura** për llogaritjen e kesaj takse i takon Specialisteve të Sektorit , Sektori i Taksave dhe i Tarifave Vendore, ( terreni) në Bashkinë Librazhd dhe raportimi nga subjektet për numrin e personave të regjistruar në regjistër.

**Afati për pagesën e kësaj takse** së mbledhur nga taksapaguesi për fjetjen në hotel, kalohet në llogari të Bashkisë Librazhd brenda datës 5 te muajit pasardhës.

Subjektet duhet të bëjnë vetëdeklarimin e numrit të netëve të qëndrimit në hotel (vjetore) shoqëruar me dokumentacion justifikues. Në rastet kur subjektet nuk mbajnë regjistër të klientëve që flejnë në hotel, administratës i lind e drejta të bëjë vlersimin.

Taksa e fjetjes në hotel për mos dhënie informacioni nga subjektet llogaritet jo më pak se 300 ditë kalendarike në vit për një person për shërbimin Hotelier.

**Sanksione:** Për mospagesë në afatin e caktuar do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19,05.2008, “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperisë” dhe do të aplikohet gjobë në masën 0.06 % çdo dite vonesë, por jo më shumë se 365 dite.

## **12. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve të transportit rrugor.**

**Baza e taksës:** Lloji i mjetit të transportit rrugorë është bazë për taksën: Cilindrata në  $\text{cm}^3$  x

koeficientin fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit.

**Detyrimi** për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit.

**Drejtoritë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR)** janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura.

**Afati** i derdhjes së taksës mujore të mbledhur nga kjo drejtori, është brenda datës 30 të çdo muaji, për llogaritë organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësisive të qeverisjes vendore, mbështetur në vend banimin e taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit. Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhen me anë të faturës për arkëtim, 25 % të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësisia e qeverisjes vendore.

Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrimit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave

**Struktura e ngarkuar** për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

## **13. Renta Minerare**

**Baza e taksës:** Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:** Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë Bashkisë Librazhd, ku zhvillohet veprimtaria.

**Agjent tatimor:** Bazuar në ligjin 9975 dt 28.07.2008 “ Per taksat kombetare “ i ndryshuar Drejtorite Rajonale Tatimore dhe Deget e Doganave jane Agjent tatimor te kesaj takse.

**Afati i pagesave:** Brenda datës 30 të çdo muaji, agjentet tatimor dërgojnë informacion analitik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të buxhetit në Ministrinë e Financave, për vlerën e rentes minerare të mbledhur, dhe subjektin tatimore sipas njësive të qeverisjes vendore ku ushtrojnë aktivitetin.

### **Derdhja e detyrimit nga agjentet:**

Pjesa e të ardhurave nga renta minerare, 5 % të saj e përcaktuar me ligj, i takon njësive të qeverisjes vendore, dhe shpërndahet nga struktura përgjegjëse e buxhetit në Ministrinë e Financave. Ministria e Financave njofton zyrtarisht drejtorinë rajonale të tatimeve/doganave, respektive, dhe njësive të qeverisjes vendore, për masën e llogaritur të shpërndarjes së të ardhurave nga renta minerale. Drejtoria Rajonale e tatimeve dhe Doganave paraqesin kërkesë për transferimin e fondit në degen përkatëse të thesarit. Dega e thesarit ku ndodhet Drejtoria Rajonale tatimore e tatimpaguesit procedon, duke përdorur metodën e transferimeve të brendshme në sistemin informatizuar financiar të Qeverisë.

## Kapitulli II

### B. TARIFAT VENDORE NJËSISA ADMINISTRATIVE LIBRAZHD

**Llojet e tarifave subjekt i këtij vendimi janë:**

1. Tarifa e pastrimit, largimit dhe e kompostimit të mbeturinave.
2. Tarifa e ndriçimit dhe e gjelberimit
3. Taksa për zënie e hapësirave publike
4. Tarifa shërbimi në varrezat publike
5. Tarifa e shërbimit veterinar
6. Tarifat në tregun e organizuar
7. Tarifa e parkimit ( vendqendrim) të automjeteve
8. Tarifat për dhenie license e certificate në sektorin e transportit.
9. Leje të drejta autorizime informacione , vertetime .
10. Tarife për automjetet që futen në qytet për furnizime.
11. Tarife për librat e udhëtimit brenda vendit
12. Tarife për dhenie leje dhe ushtrim aktiviteti
13. Tarife për dhenie license për stacionet e shitjes me pakice të karburanteve
14. Tarifat në sektorin e Urbanistikës
15. Tarife për linjat ajrore dhe nentokesore
16. Tarife për mbetjet inerte
17. Tarife për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit
18. Tarife e shërbimeve që kryhen nga struktura e mbrojtjes nga zjarri e shpëtimi
19. Tarife në sektorin e Pyjeve , dhe kullotave ( shtojca Nr.1,2,3)
20. Aneksa të tjera mbi shërbime.

Në bazë të nenit 35 të ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006, Bashkia krijon të ardhura nga tarifat vendore për:

- Shërbime publike që ato afrojnë (pastrim,gjelberim,ndricim, etj.)
- Të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore (psh, tarifë parkimi,tarifa përdorimi të shesheve vendore etj.)
- Dhënia e licencave, lejeve, autorizimeve, lëshimi i dokumentave etj.

Në përgjithësi tarifat e shërbimeve përcaktohen me synimin mbulimin e kostove të tyre.

Me vendosjen e tarifave nga Bashkia kemi në konsideratë vendosjen në lidhje të drejtpërdrejtë midis tarifës dhe qëllimit të përdorimit të saj, me synimin që qytetarët të ndërgjegjësohen dhe të ndjejnë efektin e pagesës së bërë prej tyre.

Përcaktimi i tarifës do të shoqërohet me publikim dhe njoftim që personat, familjarët apo subjektet të njihen në kohën e duhur.

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

Llojit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, sipas të dhënave nga Drejtoria e Tatimeve, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.139/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, nën titullin III “E drejta mbledhjes së të ardhurave dhe kryerjes së shpenzimeve” shkronja b:

“Bashkitë vendosin taksa dhe tarifa vendore për shërbimet që kryejnë si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e Bashkisë”.

Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në ligj, Këshilli Bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifat do të mblidhen nga vetë strukturat Bashkiake apo nga një agjent.

Në vendosjen e tarifave të shërbimit, Njësia Administrative Librazhd është ndarë gjeografikisht në dy Zona (bashkangjitur harta e qytetit):

1. Zona A

2. Zona B

**Në Zonën A:** përfshihen bizneset që zhvillojnë aktivitetet në Rrugën kryesore të qytetit:

Pedonale: - Vendndodhja e Deges “Reiffeisen Bank”, Kryqëzimi rruga e spitalit me rrugën e stacionit deri në OTP Bank .

**Në Zona B** përfshihen bizneset që zhvillojnë aktivitetet në pjesën që nuk përfshihen në zonën A.

#### **Lehtësime fiskale për vitin 2026.**

- 1- Për bizneset e reja të cilat administrohen nga vajzat dhe djemtë deri në moshën 25 vjeçare, tarifat vendore janë zero për vitin e parë.
- 2- Për bizneset e reja të cilat punësojnë mbi 20 punonjës , Tarifat Vendore reduktohen në masën 50% në dy vitet e para të aktivitetit.
- 3- Për bizneset e reja me aktivitet si agroturizëm , prodhime bujqësore , guida, kamping, hiking për 2 vitet e para të aktivitetit ,tarifat vendore janë zero.
- 4- Përjashtohen nga taksa ,tokat bujqësore , që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes së tyre ( sipas VKM) .
- 5- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja , përjashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “ agroturizëm” sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit ( sipas VKM).

#### **1. Tarifa e pastrimit, largimit të mbeturinave.**

**Përkufizimi:** “Tarifë e pastrimit dhe largimit të mbeturinave” është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Librazhd dhe njësive të saj administrative.

**Baze e tarifës:** Numri i familjeve, numri bizneseve dhe numri i institucioneve ne Njësinë Administrative Librazhd që ju ofrohet ky shërbim.

**Niveli i tarifës së pastrimit:** Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

#### **Tarifë pastrimi, largimi të mbeturinave Njesia Librazhd.**

Nr	GRUPIMI I TATIMPAGUESVE	Njesia	Vlera
<b>A.</b>	<b>Tarifa e pastrimit per bizneset dhe institucionet</b>		
1.1	Për cdo subjekt te biznesit te vogel		

	te artikujve industriale , artikujve te ndryshem kate , bar- kafe, transporti, shërbime si këpucar , rrobaqepës , parukeri etj të ngjashme.	Lek/vit	7,000
1.2	Për çdo subjekt të biznesit të vogël që ndodhet në zonën pedonale ( zona A). Per cdo subjekt te biznesit te vogel te artikujve ushqimore,bulmet , bujtina, profesione te lira, prodhim, shitje lende ndertimi , inerte , ndertim , projekte , zbatime, konsulence, IT, software. Per niptet sekondare te subjekteve te biznesit te vogel qe kane vetem seline ne Bashkine Librazhd. <u>Për çdo subjekt të biznesit të vogël ndërtimi pamvarësisht adresës qkb.</u>	Lek/ vit	11,000
1.3	Per cdo subjekt te biznesit te vogel qe ushtrojne aktivitet me nje nipt dy aktivitetete ne te njejen vendodhje .	Lek/vit	16,000
1.4	Per niptet sekondare dhe subjektet e biznesit te madh qe kane seline ne Bashkite e tjera ( ose jane me kontrate te lidhur me Bashkine Librazhd)	Lek/vit	110,000
1.5	Per subjektet e biznesit te madh , te regjistruar ne regjistrin e biznesit, ne zonen pedonale	Lek/vit	440,000
1.6	*Per biznesin e madh subjekte juridik,supermarket te regjistruar ne regjistrin e biznesit jashte pedonale .  *Per subjektet te biznesit te madh te regjistruar ne regjistrin e biznesit si bankat .	Lek/vit	220,000
1.7	* Per cdo subjektet te biznesit te madh i regjistruar ne regjistrin e biznesit si : fondacionet. * Per cdo subjektet biznesit te madh , bar – restorant , baste sportive hotele , motele bujtina . * Per cdo subjekt i profesioneve te lira, farmaci , te biznesit te madh. * Per cdo leje zhvillimore ndertimi mbi 4 kate per subjektet e ndertimit qe kane seli ne teritorin e Bashkise Librazhd. * Per ndermarrjet dhe institucionet shteterore, Per ndermarrjet dhe institucionet jo shteterore qe kryejne sherbime dhe realizojne te ardhura	Lek/vit	55,000

1.8	* Per cdo njesi shitje te biznesit te madh ,ushqimore.  * Per cdo njesi <b>shitje</b> te biznesit te madh materiale ndertimi, shitje lende drusore, industriale , kabllore , internet * Subjektet e biznesit te madh si : shitje karburantesh jashte rruges nacionale.	Lek/ vit	88,000
1.9	Për cdo njesi <b>prodhimi</b> te biznesit te madh per fasonet .	Lek/vit	165,000
1.10	Për çdo njesi <b>prodhimi</b> te biznesit te madh i vetepunesuar (jo fasone).	Lek/vit	110,000
1.11	* Per kompanite e sigurimit me nipte sekondare dhe subjektet e biznesit te madh qe kane vetem seline ne Bashkine Librazhd  * Per cdo leje zhvillimore ndertimi me 4 kate per subjektet e ndertimit qe nuk kane seli ne teritorin e Bashkise Librazhd  *Per subjektet e transportit te udhëtarëve të biznesit të madh	Lek/vit	27,500
1.12	Per cdo firme ndertimi per seline administrative Bashkia Librazhd	Leke	44,000
1.13	Per subjektet e transportit te mallit te biznesit te madh.	Lek/vit	33,000
1.14	Subjektet e biznesit te madh si : shitje karburantesh ne rrugen nacionale	Lek/vit	110,000
1.15	Per konvikte,pensione,shtepi femijesh,spitale shteterore etj.	Lek/dhom/vit	150
1.16	Per tregtaret brenda tregut me kontrate me Bashkine	Leke/vend/muaj	100
1.17	Per OJF dhe shoqatat	Lek/ vit	8,000
1.18	Per ambulantet	Lek/vit	2,000
1.19	<u>Për çdo subjekt të biznesit të vogël të artikujve ushqimore + fruta perime ,bar- restorante .</u>	Lek/ vit	15,000
<b>B. TARIFA PASTRIMIT PER FAMILJET QYTET</b>			
1.19	Pastrimi, largim mbeturinash per familjet	Lek/vit/familje	1,800
1.20	Pastrimi, largim mbeturinash, per familjet me ndihme ekonomike, invalidet, te vetmuarit dhe veteranet e luftes.	Lek/vit/familje	600

**Tarife pastrimi,largimi te mbeturinavene 6 Njësitate Administrative Librazhd .**

Nr.	Tarifa e Pastrimit dhe largimit te mbeturinave	Njesia	Vlera
			e tarifes leke / ne vit
1.21	Ambulant	Lek/vit	2,000
1.22	Për çdo subjekt te biznesit te vogel ,shitje me pakice dhe shumicë, prodhim, <u>trnsport</u> , shërbime e profesione <u>IT</u> , <u>software</u> ojf etj.	Lek/vit	<u>7,000</u>
1.23	Subjektet e biznesit te vogel ,kultivim peshku,dhe biznese më shume se nje aktivitet në nipt/license.	Lek/vit	20,000
1.24	Për cdo subjekt i biznesit te madh profesione te lira, <u>transportit</u> .	Lek/vit	33,000
1.25	*Subjektet e biznesit te madh si :kultivim peshku, projektme zbatime ,subjektet e ndertimit,prodhim inertesh.etj te ngjashme me to. * Per cdo njesi shitje te biznesit te madh (Bar-restorant,lojra,fati,baste sportive, Hotele,Motele).	Lek/vit	44,000
1.26	Subjektet e biznesit te madh si : Hec-e,	Lek/vit	220,000
1.27	Subjektet e biznesit te madh si subjektet per shfrytezim minierash, gurore.	Lek/vit	165,000
1.28	Pastrimi, largim mbeturinash per familjet	Lek/vit/familje	500
1.29	Pastrimi, largim mbeturinash, per familjet me ndihme ekonomike, invalidet, te vetmuarit dhe veteranet e luftes.	Lek/vit/familje	200
1.30	Per cdo subject i biznesit te vogel bar restorant	Lek/vit/familje	15,000

**Shenim:** Tarifat e mësipërme të pastrimit kompostimit dhe largimit te mbeturinave në gjashtë njësitate administrative .

**Zona A.** Pagesa e tarifës së pastrimit. sipas percaktimeve të mësipërme të tabelës.

Të gjithë subjektet e biznesit të vogël,të madh, institucione ambulant sipas percaktimeve të mësipërme që kanë vendndodhjen dhe ushtrojnë aktivitetin në të dy anët e rrugës Nacionale Librazhd - Prrrenjas ( nga kufiri ndarës territorial me Bashkinë Elbasan, deri ne kufirin ndarës territorial me Bashkinë Prrrenjas) do të paguajnë tarifën e pastrimit sipas percaktimeve në tabelën e mësipërme. Te gjithë subjektet e biznesit te vogel qe kane vendndodhjen dhe ushtrojne aktivitetin pergjate rruges automobilstike te asfaltuar. Jane shtuar 5 fshatra per sherbimin e pastrimit si : në Hotolisht Fshat , Vulçan , Polis Gostimë 2, Prevall. dhe Steblevë .

## *Për Njësine Administrative Qëndër*

Librazhd-Dorez, Librazhd-Togez, Librazhd Katurman , Librazhd- Gizavesh, Librazhd- Babje,

Librazhd – Dragostunje , Librazhd- Semes , Librazhd- Spathare , Librazhd Qender.

### *Për Njësine Administrative Hotolisht*

Librazhd – Hotolisht, Librazhd – Frare, Librazhd- Dardhë, Librazhd –Xhyrë, Librazhd-Çerçan, Librazhd-Kokreve, Librazhd - Vehçan, Librazhd- Hotolisht Fshat ,Librazhd - Vulçan.

### *Për Njësine Administrative Polis*

Librazhd –Mirakë Plane ,Librazhd –Mirakë Gjovaç, Librazhd –Polis Gostimë 1, Librazhd – Polis Qëndër, Librazhd - Polis –Gostimë 2

### *Për Njësine Administrative Lunik*

Librazhd – Zgosht , Librazhd – Lunik ,Librazhd- Prevall

### *Për Njësine Administrative Orenjë*

Librazhd – Funares ,

### *Për Njësine Administrative Steblevë*

Librazhd – Fushe Studen, Librazhd –Borovë , Librazhd- Stebleve

## **Zona B**

Subjektet e biznesit te vogel, që kane vendndodhjen dhe ushtrojne aktivitetin jashte percaktimeve te zones A nuk do jene subjekt i pageses se tarifes se pastrimit për vitin 2026.

**Struktura e ngarkuar për mbledhjen** e kësaj tarife janë njësitet administrative , Drejtoria e të Ardhurave Vendore , pranë Bashkisë Librazhd.

**Për familjet:** Vjelja e kësaj tarife behet me Shoqerine Rajonale Ujësjellës Kanalizime sha si agjent tatimor te perfshira ne faturen e ujit te pijeshem ( sipas marreveshjes bashki me sh.a ujesjelles kanalizime).

**Për Bizneset:** Vjelja bëhet nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore , pranë Bashkisë Librazhd nëpërmjet arkës së Bashkisë dhe bankave të nivelit të II-të.

**Afati i pagesës** së detyrimit është data 30 Shtator të vitit fiskal për biznesin e madh dhe 30 Nëntor të vitit fiskal per biznesin e vogël dhe 31.12.2026 për familjarët .

**Sanksione:** Për mospagesë në afatin e caktuaro të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19,05.2008, “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperisë” dhe do të aplikohet gjobë në masën 0.06 % çdo dite vonesë, por jo më shumë se ne 365 dite .

Detyrimi llogarite per cdo objekt banimi . Detyrimin per pagesen e tarifes se pastrimit e ka çdo pronar / posedues qe perdor objektin e banimit .

**Afati I njoftimit** të tatimpaguesit do të jetë deri në datën 31.05.2026

## **2.Tarifa e ndriçimit dhe Gjelberimit.**

**Përkufizimi:** Tarifa e ndriçimi-gjelberimit është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësitek 35dministrate tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizikapo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomikebrenda territorit të Bashkisë Librazhd dhe njësive të saj administrative.

**Baze e tarifës:** Numri I familjeve, numri bizneseve dhe numri I institucioneve ne Njësine Administrative Librazhd qe ju ofrohet ky sherbim.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së ndricimit dhe gjelberimit janë si më poshtë:

Nr	GRUPIMI I TATIMPAGUESVE	Njesia	Vlera
<b>A. TARIFA NDRICIM-GJELBERIM BIZNES &amp; INSTITUCIONE</b>			
2.1	Tarifa e gjelberimit për cdo subjekt te biznesit të vogël shitje,prodhim dhe shërbime transporte etj	Lek/vit	1000
2.2	Tarifa e ndricimit për cdo subjekt te biznesit të vogël shitje,prodhim dhe shërbime transporte etj	Lek/vit	1000
2.3	Tarifa e gjelberimit për cdo subjekt të biznesit të vogel në pedonale,profesione te lira, ojf , prodhimi, projektim, konsulence,etj	Lek/vit	2500
2.4	Tarifa e ndricimit për cdo subjekt të biznesit të vogel në pedonale,profesione te lira, ojf , prodhimi, projektim, konsulence,etj	Lek/vit	2500
2.5	Tarifa e gjelberimit per cdo subjekt te biznesit te madh, institucionet shteterore dhe jo shteterore.	Lek/vit	7500
2.6	Tarifa e ndricimit per cdo subjekt te biznesit te madh, institucionet shteterore dhe jo shteterore	Lek/vit	7500
<b>B. TARIFA NDRICIM-GJELBERIM FAMILJE</b>			
2.7	Tarifa e gjelberimit per cdo familje	Lek/vit/familje	200
2.8	Tarifa e ndricimit per cdo familje	Lek/vit/familje	400
2.9	Tarife dhe gjelberimit per familje me ndihme ekonomike, invalidet,(kane 1 pjesetar te familjes)te vetmuarit	Lek/vit/familje	200
2.10	Tarife ndricimi per familje me ndihme ekonomike, invalidet,(kane 1 pjesetar te familjes)te vetmuarit	Lek/vit/familje	200

**Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e të Ardhurave Vendore , pranë Bashkisë Librazhd.**

**Për familjet:** Vjelja e kësaj tarife behet me Shoqeria Rajonale Ujësjellës Kanalizime sha si agjent tatimor te perfshira ne faturen e ujit te pijeshem.

**Për Bizneset:** Vjelja bëhet nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, nëpërmjet arkës së Bashkisë dhe bankave te nivelit te II-të.

**Afati i pagesës së detyrimit** është brenda datës 30 Shtator të vitit fiskal për biznesin e madh

dhe 30 Nëntor të vitit fiskal për biznesin e vogël dhe 31.12.2026 për familjarët .

**Sanksione:** Për mospagesë në afatin e caktuar do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë" dhe do të aplikohet kamate në masën 0.06 % çdo dite vonesë, por jo më shumë se ne 365 dite.

**Afati i njoftimit** të tatimpaguesit do të jetë deri në datën 31.05.2026.

### **3.Tarifa për zënie e hapësirave publike**

Tarifa e shfrytëzimit të sipërfaqeve publike

**Përkufizim:**Hapësire publike është hapësira e jashtme si rruga,trotuari,sheshi,lulishtja,parku e të tjera të ngjashme në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik/dhe ose privat.

Hapësira publike përfshin rrugë,kalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun,ose në shërbim të përdorimit publik.Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi konsiderohet vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash, sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bimë dekorative, me kangjiella, drurë dekorative, etj.

**Detyrimi për pagesën:** Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit te Territorit harton planin për zënie e hapësirës publike në të gjithë territorin e Bashkisë Librazhd, ku përcakton zonën, sipërfaqen, periudhën dhe qëllimin e lejuar të shfrytëzimit.

**Drejtoria Juridike** , bazuar në planin e hartuar, nënshkruan kontratat me subjektet që kanë paraqitur kërkesën.

**Drejtoria e Taksave Vendore** faturon, monitoron dhe ndjek shlyerjen e detyrimit. Derdhja e të ardhurave për këtë tarifë në favor të bashkisë, se bashku me taksat e tarifave vendore .

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës është Drejtoria e të Ardhurave Vendore , pranë Bashkisë Librazhd.

**Baza e taksës** për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m<sup>2</sup>, e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi.

**Pagesa e taksës** për zënie e hapësirës publike do të jetë vjetore dhe do të likujdohet së bashku me taksat dhe tarifave vendore.

**Struktura e ngarkuar për llogaritjen** dhe mbledhjen e taksës për zënie e hapësirave publike është Sektori i Tatim-Taksave ,Njesite Administrative , Drejtoria e të Ardhurave Vendore , pranë Bashkisë Librazhd.

**Zyra e urbanistikës** ngarkohet për hartimin e dokumentacionit dhe përcaktimin e sipërfaqeve /hartave , planimetrike objekt i kësaj tarife si dhe publikimin e tyre.

#### **Aftet e pageses se taksës:**

Afati i pageses do të jetë brenda datës 30 Shtator të vitit fiskal për biznesin e madh dhe 30 Nëntor të vitit fiskal për biznesin e vogël .

**Sanksione:**Për mospagesë në afatin e caktuar për kategorinë biznese/institucione do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe do të aplikohet gjobë në masën 0.06% çdo dite vonesë, por jo më shumë se 365 dite .

**Afati i njoftimit të tatimpaguesit** do të jetë deri në datën 31.05.2026.

Niveli i tarifës për shfrytëzimin e hapësirave publike llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit dhe shprehet në lekë/m<sup>2</sup>/muaj. Për qëllim të shprehjes së drejtë të nivelit

te tarifës, klasifikimi është i ndarë në 4-kategori që i përkasin e 4-zonave (A,B,C,Ç) në qytet dhe 6 njesite e tjera administrative.

1. Zona A
2. Zona B
3. Zona C
4. Zona Ç

Niveli i tarifës së shfrytëzimit të hapësirave publike, paraqitet sipas kësaj ndarje në tabelat mëposhtme:

**ZONA .A .** Përfshin zonën pedonale nga Banka OTP, Raiffeisen Bank , kryqëzimi i rrugës së spitalit me rrugën e stacionit të trenit .

Nr.	Hapësire Publike	Niveli i tarifës lekë / muaj për m <sup>2</sup>
3.1	Zenie hapësire publike për sipërfaqen në m <sup>2</sup> për qëllime biznesi. Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi si: <ul style="list-style-type: none"> <li>• vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit,</li> <li>• vendosje tavolinash sipërfaqet e zëna me platforma,</li> <li>• sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bimëdekorative, me kangjella, drurë dekorativ.</li> <li>• kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to.</li> </ul>	300

**ZONA .B.** Përfshin hapësirat publike që shfrytëzojnë subjektet e karburanteve .

Nr.	Hapësire Publike	Niveli i taksës lek/ muaj për m <sup>2</sup>
3.2	Zënie hapësire publike për karburantet	200

**ZONA .C.**

Për subjektet e biznesit të madh, biznesi i vogël, ambulante që kanë vendndodhjen dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre jashtë percaktimeve të pikës numer 1(nje) Zona A,do të paguajnë taksën për zenie të hapësirës në lekë/m<sup>2</sup>/muaj sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Hapësire Publike	Niveli i taksës lekë/m <sup>2</sup> /në muaj
3.3	Zënia e Hapësirës publike për qëllime biznesi	150

**ZONA .Ç.** Për gjashtë Njësitet Administrative .

Përfshin hapësirat publike që shfrytëzohen nga subjekte që ushtrojnë aktivitet në gjashtë njësitet administrative të Bashkisë Librazhd .

Nr.	Zënia e hapësirës publike	Niveli i taksës lek/m <sup>2</sup> (në muaj)
3.4	Organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi si vendosje	100

mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash sipërfaqet e zëna me platforma , sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to.
---

#### **4. Tarife per mbetjet inerte**

Bazuar ne Vendim e Keshillit Bashkiak nr.78, datë 10.06.2019”Per Miratimin ne venddepozitimit te mbetjeve inerte ne Bashkine Librazhd “ , VKB,Nr .8, date 31.01.2020 “ Për per mbetjet inerte “ ,detyrimin per arketimin e kesaj tarife e kane subjektet private juridike e fizike ku mbetjet pas ndertimeve duhet te depozitohen ne vendin e miratuar kundrejt tarifes se percaktuar.

Nr	Emërtimi	Njësia	Vlera në lekë
4.1	Tarife për mbetjet inerte	Lekë / ton	180

**Struktura e ngarkuar per llogaritjen dhe mbledhjen e kesaj tarife është Policia Bashkiake dhe I.M.T .**

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e të Ardhurave Vendore të Bashkisë Librazhd .**

#### **5.Tarifa shërbimi në varrezat Publike në zbatim të VKM Nr. 402 , datë 05.07.2023**

**Përkufizimi:** Tarifa e shërbimeve të varrimit është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit funeral të marrë, për çdo rast vdekje, ne varrimin, hapjen e varrit dhe rregullimin e varrit nga shërbimet e varrimit për banoret e Bashkisë Librazhd.

**Bazë e tarifës:** Numri i rastit të vdekjeve dhe shërbimeve qe realizohen nga shërbimet funerale ne Njësinë Administrative Librazhd.

**Niveli i Tarifës:** Është ndarë në tre-kategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së shërbimit për secilën kategori janë si më poshtë:

Nr	Kategoritë	Njësia	Lekë
5.1	Tarifë varrimi	Lek/Cdo rast	5000
5.2	Hapje varri	Lek/Cdo rast	2000
5.3	Rregullim varri	Lek/Cdo rast	1000

**Struktura ngarkuar per llogaritjen e detyrimit dhe informimin te kesaj tarife është Drejtoria e Shërbimeve.**

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife bëhet për çdo rast shërbim/vdekje nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore Vendore, nëpërmjet arkës së Bashkisë dhe Bankave të Nivelit të II.**

#### **6. Tarifa të shërbimit veteriner.**

**Baza e tarifës:** Janë subjekte që në aktivitetin e tyre të biznesit kanë thertore kafshësh në territorin e Njesisë Administrative Librazhd.

- Synohet të planifikohet një paketë fiskale sa më reale në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor në fuqi, në mënyrë që nga strukturat e tjera të sigurohet një mirëadministrim në burimet njerëzore dhe materiale, veçanërisht ato financiare që vijnë si rrjedhojë e zbatimit

**Adresa: Bulevardi "Gjorg Golemi", Librazhd [www.bashkialibrazhd.gov.al](http://www.bashkialibrazhd.gov.al) [info@bashkialibrazhd.gov.al](mailto:info@bashkialibrazhd.gov.al)**

të sistemit të taksave e tarifave të sipërpërmendur, për të përmbushur misionin e përcaktuar.

- Synohet të bëhet një shpërndarje sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin i nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit, sipas vendndodhjes gjeografike në gjithë territorin e Bashkisë Librazhd.

Propozimet synojnë të jenë në përputhje me ndryshimet ligjore të ndodhura.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

- a) Hartimin e një pakete fiskale të integruar;
- b) Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat njësi vendore duhet të arkëtojë të ardhura;
- c) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësive për çdo taksë dhe tarifë, pjesë e kësaj pakete fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent;
- d) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifat.

Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët:

- Taksim i drejtë;
- Tarifim mbështetur në kosto;
- Klasifikim i biznesit, qarkullim vjetor, lloji i aktivitetit;
- Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;

h) Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon njësi (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha taksat, përcaktimi i bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji;

i) Rikategorizimi dhe detajimi i taksave e tarifave ;

j) Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësi (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendosen;

k) Aplikimi i stimujve apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, siç parashikon ligji.

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur ne project vendim jepet legjislacioni fiskal vendor, i cili është konsultuar për të hartuar këtë paketë fiskale.

Per miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për Bashkinë Librazhd, po japim sqarimet si më poshtë per "Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore" të Njësisë Administrative dhe 6 Njësie të tjera Administrative për vitin 2026 bashkelidhur P/ vendimit.Sistemi i taksave dhe tarifave vendore ka te beje me taksat te cilat jane te bazuara ne ligj ne VKM , ligjet ,dhe tarifate vendore te propozuara e te miratuara me VKB.

## **A. TAKSAT VENDORE**

### **Llojet e taksave subjekt i ketij vendimi :**

Kemi 13 kategorizime te taksave vendore

#### **1.Taksa mbi pasurinë** e paluajtshme nga pika 1.1 deri në pikën 1.15

.Pasuri e paluajtshme janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

#### **2. Parashikime të përbashkëta për Taksën e Pasurisë së Paluajtshme** nga pika 2.1 deri në pikën 2.8

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- a) taksa mbi ndërtesat;
- b) taksa mbi tokën bujqësore.
- c) taksa mbi truallin

#### **3. Taksa mbi ndërtesat** nga pika 3.1 deri në pikën 3.23

Në zbatimin e pikës 3 të nenit 2 të VKM Nr. 132/2018, i cili parashikon se "Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind."

% e shkallës së taksës mbi ndërtesat për banim ne qytet dhe ne fshat është zbritur -30% .

% e shkallës së taksës mbi ndërtesat për veprimtari ekonomikene zonat jashtë qytetit 0.2%

% e shkallës së taksës mbi ndërtesat për veprimtari ekonomike ne qytet eshte zbritur -20%(0.17%

- Për gjashtë njësitë administrative jashtë qytetit , si Hotolisht , Polis , Librazhd Qender , Lunik , Stebleve , Orenjë të cilat iu bashkuan njësisë së qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, do të aplikohet reduktimi i çmimit mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1 të VKM Nr. 132/2018, i ndryshuar.

- % e reduktimit është në masën 35%. përjashtuar zonat rezidenciale.

Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/ njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, sipas kategorive të ndërtesave, si më poshtë:

- a) 0,05%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën

**Adresa: Bulevardi "Gjorg Golemi",Librazhdwww.bashkialibrazhd.gov.al info@bashkialibrazhd.gov.al**

zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

*Per 6 njesite administrative per vitin 2026 kemi reduktim te cmimit reference 35% eshte bere nendarje zonale / nenzonale te territorit , brenda juridiksionit , shkalla e takses minus 0.2% . si me poshte "kurse per njesine administrative qytet shkalla e takses minus 15% dhe cmimi reference 44,000 leke .*

- Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) here më lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë  
Njësia administrative qytet 112.2 lek/m<sup>2</sup> , në njesite administrative jashtë qytetit 85.8 lekë /m<sup>2</sup>.
- Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve  
Njësia administrative qytet 52.36 lek/m<sup>2</sup> , në njesite administrative jashtë qytetit 40 lekë /m<sup>2</sup>.
- Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit.  
Njësia administrative qytet 22.4 lek/m<sup>2</sup> , në njesite administrative jashtë qytetit 17.16 lekë /m<sup>2</sup>
- Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuar për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshijë ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse. Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura  
Njësia administrative qytet 37.4 lek/m<sup>2</sup> , në njesite administrative jashtë qytetit 28.6 lekë /m<sup>2</sup>
- Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor  
Njësia administrative qytet 22.4 lek/m<sup>2</sup> , në njesite administrative jashtë qytetit 17.16 lekë /m<sup>2</sup>
- Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indeksohet me koeficientin 0.2 (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK  
Njësia administrative qytet 14.9 lek/m<sup>2</sup> , në njesite administrative jashtë qytetit 11.44 lekë /m<sup>2</sup>

### **Perqindja e shkalles se takses per banim- 30% pa ndryshime nga viti paraardhes .**

**Çmimi reference 44000 lek \*0.05% për banim.**

**Çmimi reduktuar 28600 leke 0.05% per njesite jashte qytetit**

**Adresa: Bulevardi "Gjorg Golemi", Librazhd [www.bashkia.librazhd.gov.al](http://www.bashkia.librazhd.gov.al) [info@bashkia.librazhd.gov.al](mailto:info@bashkia.librazhd.gov.al)**

- Ndërtesa e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet, banesat dhe ndërtesat e ngjashme 15.4 leke ne qytet dhe 10 lek /m2 ne njesite jashte qytetit
- Garazhet e mbyllura 15.4 leke ne qytet dhe 10 lek /m2 ne njesite jashte qytetit
- Bodrumet 15.4 leke ne qytet dhe 10 lek /m2 ne njesite jashte qytetit
- Çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nën tokë, që nuk përdoret apo shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit 15.4 leke ne qytet dhe 10 lek /m2 ne njesite jashte qytetit

Reduktim te cmimit reference per njesite administrative jashte qytetit . Nga viti i meparshem e shikojme te arsyeshme si nje mundesi per likuidimin e taksës se ndërtesës si dhe shtrirja e bazës sa më shumë e mundur ,regjistrimi dhe informalizimi i tyre në regjistrin e taksapaguesve ndaj Bashkisë Librazhd .

Përfshirje:Përfshihen nga pagesa e taksës së ndërtesës:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjve të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
- ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paafte për punë;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurës

**4. Taksa mbi tokën bujqësore** nga pika 4.1 deri në pikën 4.8 pa ndryshime për vitin 2026  
Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor .

Taksa mbi tokën bujqësore zbatohet mbi bazën e VKM,

Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe mbledhjen e taksës se tokës bujqësore, është zyra e tatim-taksave te Njesise Administrative perkatese, Bashkia Librazhd.

Afati i njoftimit të tatimpaguesit do të jetë deri në datën 31.05.2026.

Për kategorinë “Familjare”, taksa e tokës bujqësore do të paguhet, deri në datën 31.12.2026

**5. Taksa mbi truallin** nga pika 5.1 deri në pikën 5.8 pa ndryshime për vitin 2026

Adresa: Bulevardi “Gjorg Golemi”,Librazhd[www.bashkialibrazhd.gov.al](http://www.bashkialibrazhd.gov.al) [info@bashkialibrazhd.gov.al](mailto:info@bashkialibrazhd.gov.al)

Taksa mbi truallin zbatohet mbi bazen e VKM

Për familjet vlera e taksës për m<sup>2</sup> është 0.28 lek / m<sup>2</sup> në vit.

Për bizneset vlera e taksës për m<sup>2</sup> është 15 lek / m<sup>2</sup> në vit.

Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria e të Ardhurave Vendore kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër, dhe vjelja bëhet nga sektori i tatim taksave, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të Bashkisë Librazhd dhe Njësitë Administrative.

#### **6. Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogël**

Çdo subjkt, i cili kryen nje biznes, me ane te te cilit realizohet gjate vitit fiskal qarkullim me i vogel ose i barabarte me 8,000,000 ( tetemijlon) leke, u nenshtrohet detyrimeve te parashikuara.

Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit te vogel nenkuptojne çdo lloj te ardhure, te realizuar gjate periudhes tatimore dhe perfshijne, pa u kufizuar vetem ne to; te ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe sherbimeve, te ardhurat nga pjesemarrjet, te ardhurat nga interesat, te ardhurat nga shfrytezimi i pasurise se luajtshme dhe te paluajtshme.

#### **Shkalla Tatimore.**

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).

Drejtoria Rajonale eshte e ngarkuar me vleresimin, mbledhjen, kontrollin, arketimin dhe transferimin ne llogari te buxhetit te qeverisjes vendore te te ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel.

#### **7. Taksa mbi te ardhurat personale**

Nga te ardhurat personale 2 % e te ardhurave xhirohen nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave per llogari te Bashkise.

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera.

#### **8. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.**

**Nivelet e taksës se kalimit te pronesise mbi ndertesat jane:**

Ndertesat pe banim 100 lek / m<sup>2</sup>

Ndertesat per tregti e sherbime 300 lek / m<sup>2</sup>

Ndertesat te tjera 200 lek / m<sup>2</sup>.

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është zyra e regjistrimit të pasurive, sot ASHK e cila mbas përfitimit të 3% të kësaj takse dhe 97 % e derdh në llogarinë e Bashkisë brenda 10 ditëve.

#### **Përfshirjet:**

Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore e qendrore;

b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";

c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

**Adresa: Bulevardi "Gjorg Golemi", Librazhd [www.bashkia.librazhd.gov.al](http://www.bashkia.librazhd.gov.al) [info@bashkia.librazhd.gov.al](mailto:info@bashkia.librazhd.gov.al)**

i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;  
ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave. Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

### **9. Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja**

Sipas projekt – vendimit nuk ka ndryshime dhe shtesa te zerave te taksës se ndikimit infrastrukture . Per llogaritjen e detyrimit te taksës se ndikimit ne infrastrukture , legalizimet per objektin e pare llogaritet 0.5 % e cmimit sipas VKM dhe per objektin e dyte sipas llojit te pasurise nga 1-6 % .

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife e ka Sektori i Urbanistikës , të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit .

### **10. Taksa e tabelës dhe reklames**

Bazuar ne ligjin nr.106/2017, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar ,parashikohet:

Kategorite e bazes se taksës se tabelës dhe niveli i tyre jane sipas tabelës ne projekt –vendim dhe sipas ligjit dhe pa ndryshime per vitin 2026.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen** e kësaj takse është Drejtoria e te Ardhurave Vendore prane Bashkise Librazhd .

**Struktura e ngarkuar për penalitetet** përmos pajisje me lejë për vendosje table reklamuese është Policia Bashkiake, Sektori i Kontrollit Territorit .

**Për kategorinë tabelë për qëllime reklamimi**, të thjeshta dhe elektronike:

Struktura/drejtoria përgjegjëse per kontrollin e zhvillimit të territorit ngarkohet për shqyrtimin e kërkesës se subjektit, si dhe për hartimin e dokumentacionit të plotë të marrjes së lejes për vendosjen e reklamave dhe përcaktimin e sipërfaqeve objekt taksimi. Kjo drejtori njofton në mënyrë periodike Drejtorinë e te Ardhurave Vendore në lidhje me të gjitha ndryshimet në sipërfaqe (shtesa apo pakësime) që janë objekt i kësaj takse.

### **11. Taksa e fjetjes në hotel.**

Janë subjekt i Taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

*Niveli i taksës* është si më poshtë:

- Hotele me 4 e 5 yje sipas VKM niveli i taksës është 105 lek /natë qëndrimi.
- Bujtinë , fjetinë , motel për cdo natë fjetje sipas përcaktimeve është 35 lek /natë qëndrimi .

Subjektet duhet të bëjnë vetëdeklarimin e numrit të netëve të qëndrimit në hotel(*vjetore*)shoqëruar me dokumentacion justifikues.Në rastet kur subjektet nuk mbajnë regjistër të klientëve që flejnë në hotel,administratës i lind e drejta të bëjë vlersimin Detyrimi për llogaritjen e kesaj takse i takon Inspektorëve të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Drejtoria e Taksave Vendore. Derdhja e shumës së taksës së mbledhur nga taksapaguesi për

**Adresa: Bulevardi “Gjorg Golemi”,Librazhdwww.bashkialibrazhd.gov.al info@bashkialibrazhd.gov.al**

fjetjen në hotel, kalohet në llogari të Bashkisë Librazhd bëhet brenda datës se caktuar për pagese sipas kategorise se biznesit .

Taksa e fjetjes në hotel për mos dhënie informacioni nga subjektet llogaritë jo më pak se 300 dite kalendarike në vit për një person për shërbimin Hotelier.

### **12.Taksa e rregjistrimit të përvitshëm të automjeteve të transportit rrugor**

Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së, pasimbajnë komisionin prej 5 (pesë) % të totalit mujor të të ardhurave, derdhen me anë të faturës për arkëtim, 25 % të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësi e qeverisjes vendore.

**Ne bashkëpunim me DRTRR do të marrim një data beze Struktura e ngarkuar** për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

### **13.Renta Minerare**

**Baza e taksës:** Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, Renta minerare llogaritë si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:** Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë Bashkisë Librazhd, ku zhvillohet veprimtaria.

**Agjent tatimor:** Bazuar në ligjin 9975 dt 28.07.2008 “ Për taksat kombetare “ i ndryshuar Drejtorite Rajonale Tatimore dhe Degët e Doganave janë Agjent tatimor të kësaj takse.

**Afati i pagesave:** Brenda datës 30 të çdo muaji, agjentet tatimor dergojnë informacion analitik pranë Drejtorise së Përgjithshme të buxhetit në Ministrinë e Financave , për vlerën e rentes minerare të mbledhur, dhe subjektin tatimor sipas njesive të qeverisjes vendore ku ushtrojnë aktivitetin .

**Derdhja e detyrimit nga agjentet:** Pjesa e të ardhurave nga renta minerare, 5 % të saj e percaktuar me ligj, i takon njesise së qeverisjes vendore, dhe shpërndahet nga struktura përgjegjëse e buxhetit në Ministrinë e Financave. Ministria e Financave njofton zyrtarisht drejtorinë rajonale të tatimeve/doganave, respektive, dhe njesinë e qeverisjes vendore, për masën e llogaritë të shpërndarjes së të ardhurave nga renta minerale. Drejtoria Rajonale e tatimeve dhe Doganave paraqesin kërkesë për transferimin e fondit në degen perkatese të thesarit. Dega e thesarit ku ndodhet Drejtoria Rajonale tatimore e tatimpaguesit procedon, duke përdorur metodën e transferimeve të brendshme në sistemin informatizuar financiar të Qeverise.

## **B. TARIFAT VENDORE** **NJESISA ADMINISTRATIVE LIBRAZH**

Bashkia krijon të ardhura nga tarifatat vendore për:

- Shërbime publike që ato afrojnë (pastrim, gjelberim, ndricim, etj.)

**Adresa: Bulevardi “Gjorg Golemi”, Librazhd [www.bashkialibrazhd.gov.al](http://www.bashkialibrazhd.gov.al) [info@bashkialibrazhd.gov.al](mailto:info@bashkialibrazhd.gov.al)**

- Të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore (psh, tarife parkimi, tarifa përdorimi të shesheve vendore etj.)
- Dhënia e licencave, lejeve, autorizimeve, lëshimi i dokumentave etj.

Në përgjithësi tarifatat e shërbimeve përcaktohen me synimin mbulimin e kostove të tyre.

Me vendosjen e tarifave nga Bashkia kemi në konsideratë vendosjen në lidhje të drejtpërdrejtë midis tarifës dhe qelimit të përdorimit të saj, me synimin që qytetaret të ndergjegjësohen dhe të ndjejnë efektin e pagesës së bërë prej tyre.

Përcaktimi i tarifës do të shoqërohet me publikim dhe njoftim që personat, familjarët apo subjektet të njihen në kohën e duhur.

Këshilli Bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifatat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake apo nga një agjent.

Në ndarjen sipas zonave në kemi përcaktuar dy zona .

**Në Zonën A** përfshihen bizneset që zhvillojnë aktivitetet në Rrugën kryesore të qytetit:

Pedonale: - Vendndodhja e Degës "Reiffeisen Bank",- Kryqezimi rruga e spitalit me rrugën e stacionit deri - OTP Bank .

**Në Zona B** përfshihen bizneset që zhvillojnë aktivitetet në pjesën që nuk përfshihen në zonën A.

#### **Lehtësime fiskale për vitin 2026.**

1. Për bizneset e reja të cilat administrohen nga vajzat dhe djemtë deri në moshën 25 vjeçare, tarifatat **vendore janë zero** për vitin e parë. (nga 50% në 0)
2. Për bizneset e reja të cilat punësojnë mbi 20 punonjës , Tarifatat Vendore reduktohen në masën **50%** në dy vitet e para të aktivitetit. (nga 25% në 50%)
3. Për bizneset e reja me aktivitet si agroturizëm , prodhime bujqësore , guida, kamping, hiking për 2 vitet e para të aktivitetit ,tarifat vendore janë zero.
4. Përfshihen nga taksa ,tokat bujqësore , që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga casti i mbjelljes së tyre sipas VKM.
5. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja , përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuara si " agroturizëm" sipas legjislativës në fuqi në fushën e turizmit sipas VKM.

#### **Llojet e tarifave subjekt i këtij vendimi janë:**

##### **1. Tarifa e pastrimit, largimit të mbeturinave.**

**Përkufizimi:** Tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave" është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Librazhd dhe njësisë të saj administrative.

Bazë e tarifës është numri i familjeve, numri bizneseve dhe numri i institucioneve në Njesinë Administrative Librazhd që ju ofrohet ky shërbim . Tarifa e pastrimit është shtirë në 6 njesite administrative sipas zonave A.B .

**Adresa: Bulevardi "Gjorg Golemi", Librazhd [www.bashkialibrazhd.gov.al](http://www.bashkialibrazhd.gov.al) [info@bashkialibrazhd.gov.al](mailto:info@bashkialibrazhd.gov.al)**

Tarifen e pastrimit gradualisht po e cojme drejt kostos, pasi aktualisht eshte ne nivele te ulta me ate qe shpenzojme Planifikohet qe sherbimi i pastrimit per vitin 2026 te shkoje dhe ne fshatrat ku eshte asfaltuar si :

Janë shtuar 5 fshatra për shërbimin e pastrimit si : në Hotolisht Fshat , Vulçan , Polis Gostimë 2, Prevall, dhe Steblevë .

## **2. Tarifa e ndriçimit dhe gjelberimit**

Tarifa e ndriçimi është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Librazhd dhe njësive të saj administrative.

Për vitin 2026 nuk ka ndryshime, por vetëm ndarje të tarifës së ndriçimit nga e gjelbërimit.

Numri i familjeve, numri bizneseve dhe numri i institucioneve ne Njesine Administrative Librazhd qe ju ofrohet ky sherbim eshte baza e tarifes Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së ndriçimit janë sipas projekt vendimit , Vjelja e kësaj tarife per familjaret behet me Ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime sha si agjent tatimor te perfshira ne faturen e ujit te pijeshem sipas marreveshjes se lidhur me bashkine kundrejt % se komisionit qe do ti jepet Sh.a ujesjelles Kanalizimit . Për Bizneset vjelja bëhet nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, nëpërmjet arkës së Bashkisë dhe bankave te nivelit te II-të.

## **3.Tarifa per zenien e hapësirave publike**

*Tarifa e Shfrytëzimit të Siperfaqeve Publike, zona qe shfrytëzojne hapësiten publike jane grupuar ne 4 zona :*

- *Zona A : Pedonale per hapësire publike nga 200 lek / m2 në 300 lek /m2 në muaj*
- *Zona B : Hapësire publike per karburantet nga 150 lek /m2 ne 200 lek/ m2 ne muaj*
- *Zona C : Jashte percaktimeve te zones A dhe B nga 100 lek /m2 ne 150 lek/m2 ne muaj.*
- *Zona Ç : Per 6 njesite administrative nga 60 lek /m2 ne 100 lek/m2 ne muaj.*

**Zyra e urbanistikes** ngarkohet për hartimin e dokumentacionit dhe percaktimin e siperfaqeve /hartave objekt i kesaj tarife si dhe publikimin e tyre.

## **4.Tarifa shërbimi në Varrezat Publike**

Nuk ka ndryshime 2026

Për llogaritjen e detyrimit të kësaj tarife e ka në pergjegjesi Drejtoria e Shërbimeve.

Struktura e ngarkuar eshte Sektori / Drejtorise se Sherbimeve .

## **5.Tarifa të shërbimit veteriner.**

Është ndarë në dy-kategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së shërbimit për secilën kategori janë sipas projekt vendimit për të imtat dhe të trashat nuk ka ndryshime ,sipas udhëzimit të Ministrisë së bujqësisë .

**Mënyra e pagesës:**Vlera e tarifës për çdo kafshë sipas llojit, derdhet në bashki në arkën e bashkisë ose bankat e nivelit te dytë.

**Struktura e ngarkuar** për raportim të numrit të krerëve është Drejtoria Rajonale e Kontrollit Veterinar Elbasan .sipas VKM Nr 475 , datë 30.07.2021.

**Struktura e ngarkuar** për vjeljen dhe arketimin e tarifës së shërbimeve është Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

**Adresa:** Bulevardi "Gjorg Golemi",Librazhd[www.bashkialibrazhd.gov.al](http://www.bashkialibrazhd.gov.al) [info@bashkialibrazhd.gov.al](mailto:info@bashkialibrazhd.gov.al)

## **6.Tarifat e tregut te organizuar te Bashkise Librazhd**

Baza e tarifës: Jane subjekte tregtare/tregtare qe kane kontrate te lidhur me Bashkine Librazhd. dhe tregtaret ditore qe tregtojne ne hapësirën brenda dhe jashtë tregut ne territorin e Njesise Administrative Librazhd.Per vitin 2026 nuk ka ndryshime , tregu është ne rënie te numrit te tregtareve .

## **7. Tarifa e parkimit (vendqendrimit) te automjeteve**

Baza e tarifës , jane subjektet dhe pronaret e automjeteve te transportit qe sigurojne parking te rezervuar ne hapësirat publike ne territorin e Njesise Administrative Librazhd.

Niveli i Tarifës, eshte ndare ne 16-kategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së tregut per secilen kategori janë sipas projekt vendimit .

Llogaritjen e detyrimit te kësaj tarife i takon Sektorit i Taksave .

**Struktura e ngarkuar** per vjeljen eshte Drejtoria e të Ardhurave Vendore, nëpërmjet arkës së bashkisë e Bankave të Nivelit të II.

## **8. Tarifat per dhenie licenca,çertifikate, dhe leje ne sektorin e transporteve**

Tarifa e pagesave për Licenca, Çertifikata për Transport Rrugor, aplikohen sipas pasqyres te miratuar me shkresën e Ministrise te Financave Nr.13786/1 datë 27/01/2010 ,nukm ka ndryshime ne tarifa .

## **9. Leje te Drejta, Autorizime, vertetime , informacione.**

Struktura e ngarkuar per llogaritjen dhe mbledhjen e kesaj tarife jane te gjithë sektoret sipas natyres se dhenies se lejes / autorizimit/ vertetimit / informacionit ,ska ndryshime

Vjelja bëhet nga sektori i taksave dhe tarifave vendore nëpërmjet arkës se Bashkise dhe Bankave të nivelit të II.

**Perjashtime** ,per personat qe jane me ndihme ekonomike dhe invalide perjashtohen nga pagesa e marrjes se vertetimit ne Bashki.

## **10.Tarife për Autorizime për automjete që futen në qytet e furnizojnë me mallra dyqanet**

Për vitin 2026 nuk kemi ndryshime të pikës 11 të paketës fiskale .

Struktura e ngarkuar per llogaritjen dhe mbledhjen e kesaj tarife eshte specialisti i transportit dhe Policia Bashkiake per konstatimin.

Kjo tarife eshte ndare sipas ton/ te mjeteve sipas projekt vendimit .

Sipas projekt - vendimit , autorizimet do te aplikohen e paisen vetem me kerkesen e subjekteve per mjetet e tonazhit qe ata kerkojne.

## **11.Tarifa për librat e udhëtimit për shërbime turistike /të rastit të udhëtarëve brenda**

**vendit.** Libri eshte ne dy kopje, jepet subjekteve te transportit me kerkesen e tyre dhe perdoren per te levizur jashte linjes se miratuar per nevojat e tyre .

Sipas ligjit per udhëtimin Nr 8308 date date 18.03.1998 “ Per transportet rrugore “

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon sektorit te transportit.

## **12.Tarifat per Dhenie Leje per Ushtrim Aktiviteti.**

Të gjitha Lejat do të jepen në bazë të kërkesës me shkrim nga i interesuari.

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife bëhet nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në piken 13.5 kemi ndryshim nga 1000 leke në ditë në qytet bëhet 2000 lekë në dite.Pagesa bëhet nëpërmjet arkës së Bashkisë dhe Bankave të Nivelit të II.

### **13.Dhënie licënsë për stacionet e shitjes me pakicë të karburanteve**

Dhënia e licenses per stacionet e shitjes se karburanteve, per tregtimin me pakice te karburanteve, gazit te lenget te naftes per automjetet dhe njesive te lendes djegese per perdorim nga konsumatorët fundore behet nga njesite e qeverisjes vendore.

Kjo tarife aplikohet ne zbatim te V.K.M. nr.344 date 19.04.2017 per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin Nr 970 date 02.12.2015 "Per percaktimin e procedurave dhe te kushteve per dhenien e licensave dhe te autorizimeve per tregtimin e naftes, gazit e te nenprodukteve te tyre" Licënsa leshohet per nje afat 5 vjecar me te drejte riperseritjeje sipas cmimeve te percaktuara ne ligj dhe projekt vendim per vitin 2026 nuk ka ndryshim takse.

**Struktura per dhenien e licenses** per stacionet e shitjes se karburanteve, për tregtim me pakicë është zyra e shërbimeve dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore të Bashkisë Librazhd.

### **14.Tarifat ne Sektorin e Urbanistikës.**

Sipas projekt - vendimit ,nuk kemi ndryshime .

Struktura e ngarkuar per llogaritjen dhe mbledhjen e kesaj tarife ,eshte Sektori i Urbanistikes, Struktura per vjeljen e tyre eshte Drejtoria e të Ardhurave Vendore të Bashkisë Librazhd

### **15. Tarifa per linjat ajrore dhe nëntokësore**

Sipas projekt - vendimit ,nuk ka ndryshime te paraqitura.

Struktura e ngarkuar per llogaritjen dhe mbledhjen e kesaj tarife, Drejtoria e të Ardhurave Vendore te Bashkisë Librazhd dhe Njesite Administrative.

### **16.Tarife per mbetjet inerte .**

Bazuar ne Vendim e Keshillit Bashkiak nr.78, datë 10.06.2019 "Per Miratimin ne venddepozitimit te mbetjeve inerte ne Bashkine Librazhd " , VKB, Nr .8, date 31.01.2020 " Per nje shtese tarife per mbetjet inerte " , detyrimin per arketimin e kesaj tarife e kane subjektet private juridike e fizike ku mbetjet pas ndertimeve duhet te depozitohen ne vendin e miratuar kundrejt tarifes se percaktuar.Kjo tarife është 180 lek /ton mbetje inerte , sipas projekt -vendimit dhe pa ndryshime per vitin 2026.

Struktura e ngarkuar është Policia Bashkiake dhe IMT , të Bashkisë Librazhd .

Struktura e ngarkuar per vjeljen e kesaj tarife eshte Sektori Taksave dhe Tarifave,Vendore prane Bashkise Librazhd.

### **17.Tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit.**

Detyrimin per tarifen per mbrojtjen dhe permiresimin e mjedisit e kane subjektete juridike qe ushtrojne aktivitet ne fushen e prodhimit te energjise , minierat , karburantet dhe veprimtarive te ngjashme me to .Për vitin 2026 nuk kemi ndryshime.

**Struktura e ngarkuar** per raportim Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave per llogaritjen dhe mbledhjen e kesaj tarife, Drejtoria e të Ardhurave Vendore te Bashkise Librazhd .

### **18.Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.**

Nuk ka ndryshime per tarifen e sherbimeve qe kryhen nga MZSH.

**Struktura e ngarkuar per llogaritjen** dhe mbledhjen e kesaj tarife, Sektori MZSH , Bashkisë Librazhd.

### **19 .Tarifa ne Sektorin e Pyjeve Tarifa ne Sektorin e Kullotave**

Sipas projekt - vendimit pa ndryshime per vitin 2026.

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës dhe vjeljen e detyrimit jane specialistet e pyjores.Sipas projekt - vendimit ka ndryshime referuat VKM Nr. 559 date 29.07.2022.

**Adresa: Bulevardi "Gjorg Golemi",Librazhd**[www.bashkialibrazhd.gov.al](http://www.bashkialibrazhd.gov.al) [info@bashkialibrazhd.gov.al](mailto:info@bashkialibrazhd.gov.al)

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës dhe vjeljen e detyrimit janë specialistet e pyjores.

**Struktura e ngarkuar** për percaktimin e llogaritjen dhe mbledhjen e tarifave janë specialistet e pyjores .

Për kontratat e lidhura me Hecet do të ndiqen nga Drejtoria e Pyjeve dhe të Kullotave për afatin e pagesave .

## **20. Aneksë të tjera mbi shërbimet**

Sipas projekt - vendimit ,nuk kemi ndryshime me tarifa për vitin 2026.

### **Në mënyrë të përmbledhur propozojmë këto shtesa dhe ndryshime në Paketën Fiskale 2026.**

#### **Për Taksa Vendore**

Taksa dhe cmimet e takses së ndertesës

- Për vitin 2026 kemi reduktim deri 35 % të çmimit referencë në njësitë administrative jashtë qytetit.
- Numri i neteve të shërbimit hotelier nga 300 ditë në vit në 300 dite për një person për mos deklaram të numrit të personave të akomoduar .

#### **Për Tarifa Vendore**

- Te lehtësirat fiskale tek pika nr.1 nga 50% në vitin e parë në 0 tarifa për vitin e parë .
- Te lehtësirat fiskale tek pika nr.2 nga 25% në dy vitet e para ,në 50 % tarifa në dy vitet e para.
- Te pika Nr.4 dhe Nr. 5 janë lehtësira të miratuara në ligj.
- Për tarifën e shërbimit të pastrimit pika 1.2 shtohet citimi i bizneseve si ,IT Software,dhe bizneset e ndërtimit pamvarësisht adresës në qkb.
- Për tarifën e shërbimit të pastrimit pika 1.19 shtohet për bizneset ushqimore+fruta perime, bar – restorante dhe ndahet nga pika 1.2
- Për tarifën e shërbimit të pastrimit pika 1.22 shtohet citimi i bizneseve si ,IT Software dhe tarifa nga 6 mijë në 7 mijë pasi kostoja është më e lartë në njësitë administrative .
- Shtohet te pika 1.24 zëri transporti.
- Hiqet pika 1.26 pasi është i njëjti përshkrim me pikën 1.25.
- Janë shtuar zonat e shërbimit të pastrimit ( sipas dokumentacionit dhe informacionit nga sektori juridik për shërbimin e pastrimit), janë shtuar 5 fshatra për shërbimin e pastrimit si : në Hotolisht Fshat , Vulçan , Polis Gostimë 2, Prevall, dhe Steblevë me një numër prej 800 familje
- Për tarifën e ndricim gjelberimit tek biznesi është bërë ndarje tarife dhe jo ndryshim tarife .
- Tek pika 3 tarifa për hapësirat publike Zona A nga 200 lek /m2 në muaj në 300 lek /m2 në muaj.
- Tek pika 3 tarifa për hapësirat publike Zona B nga 150 lek /m2 në muaj në 200 lek /m2 në muaj.
- Tek pika 3 tarifa për hapësirat publike Zona C nga 100 lek /m2 në muaj në 150 lek /m2 në muaj
- Tek pika 3 tarifa për hapësirat publike Zona Ç nga 60 lek /m2 në muaj në 100 lek /m2 në muaj
- Tek pika 10 .8 shtohet tarifë për marrje me qera për palestrën 10,000 lekë/rast.
- Tek pika 13.5, tarifa për zgjatje orari të kohës normale të punës për bar- kafe . restorante nga 1000 lek /në ditë, bëhet në 2000 lek /ditë. .
- Shtohet pika 1.30 tarifa e pastrimit për bar restorantet në njësitë administrative .
- Hiqet pika 1.26 paketa 2025

Zyrat në Bashkinë Librazhd nuk ofrojnë shërbim nëse dokumentacioni i kërkesës nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e Drejtorsë e të Ardhurave Vendore të Bashkisë Librazhd i cili konfirmon pagesën e Taksave dhe Tarifave Vendore si për familjaret ashtu edhe për bizneset.

- Afati i njoftimit të taksapaguesve është 31.05.2026
- Afati pagesave 30.09.2026 për personat juridike , shpk , date 30.11.2026 për prsonat fizike ndërtesat social ekonomik , të dhëna me qera , ambulantë , dhe 31.12.2026 , familjaret.
- Mbas datës së përcaktuar për likuidim do të llogaritet kamatë vonesë sipas ligjit 9920 datë 19.05.2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë “ .
- Ngarkohen të gjitha Drejtoritë / Sektorët e Bashkisë Librazhd për zbatimin e Paketës Fiskale 2026.

*Ju faleminderit dhe shpresoj në miratimin tuaj !*

**DREJTORE E TË ARDHURAVE VENDORE**

**Lindita Shuli**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
KRYETARI

Nr. \_\_\_\_ .Prot

Librazhd më. \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2025

91V  
510 = 3

P / VENDIM

Nr. \_\_\_\_ datë. \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2025

PËR

MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE TË BASHKISË LIBRAZHD  
PËR VITIN 2026

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" Kreu i IX neni 54 gërma dh, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Librazhd i mbledhur sot në datën \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2025:

V E N D O S I

1. Numri i punonjësve të Aparatit të Bashkisë, Njësive Administrative, dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2026 të jetë 456 (katërqindpesëdhjetëegjashtë) punonjës.
2. Numri i punonjësve me kontratë të përkohëshme gjatë vitit 2026 do të jetë 3(tre) punonjës.
3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Bashkia Librazhd.

Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes

KRYETARI I BASHKISË  
Mariglen Disha

## RELACION

### **Për Këshillin Bashkiak**

Në lidhje me Projekt- Vendimin:

#### **“Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Librazhd për vitin 2026”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, Kreu IX, neni 54” “Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit Bashkiak”; pika dh, ku thuhet: “Në vendimin për miratimin e buxhetit, **miraton gjithashtu dhe numrin maksimal të punonjësve**, të Bashkisë, ku përfshihen Aparati, Njësitë Administrative, si dhe institucionet në varësi të saj, po ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim projekt- vendimin; **“Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë për vitin 2026”**.”

**Numri i punonjësve të Institucionit për vitin 2026 do të jetë 456 punonjës.**

Duhet të theksojmë që numri i punonjësve **për vitin 2026 nuk ka ndryshime**, është në të njëjtin nivel me vitin 2025.

Për ushtrimin e funksioneve të saj, në realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të komunitetit, në realizimin e këtyre shërbimeve në përputhje me standardet e kërkuara me ligj, ose akte të tjera normative, si dhe në të drejtat dhe përgjegjësitë e saj të përcaktuara në ligjin e mësipërm, Bashkia krijon struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të saj.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, të përcaktuara në ligj:

1. Funksionet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike
2. Funksionet në fushën e shërbimeve sociale
3. Funksionet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese
4. Funksionet në fushën e mbrojtjes së mjedisit
5. Funksionet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit.
6. Funksionet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor
7. Funksionet në fushën e sigurisë publike
8. Funksionet dhe kompetencat e deleguara
9. Funksionet në fushën arsimit bazë dhe shërbimeve në të gjitha nivelet e arsimit

Për ushtrimin e të drejtave dhe përgjegjësiave, për realizimin sa më të mirë të funksioneve, shërbimeve, dhe të gjithë misionit të saj, përcaktohet numri maksimal i punonjësve, mbi bazën e **Strukturës Organizative e Bashkise** detajuar me pozicione; drejtori/sector/specialist, punonjës administrative, punonjës mbështetës, duke përcaktuar qartë numrin e punonjësve për secilën drejtori dhe sektor, e ndare ne:

1. Struktura organizative e Aparatit të Bashkisë

Në strukturën e Aparatit përfshihen struktura (drejtori, sektore) që kryejnë veprimtari të natyrës

politikëbërëse, planifikuese, monitoruese dhe rregullatore që hartojnë dhe zhvillojnë planet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata bazuar në vizionin e Kryetarit të Bashkisë. Aparati kryen funksione monitoruese mbi strukturat ekzekutive, për mënyrën e zbatimit të masave dhe politikave sipas përmbajtjes së dokumentave strategjike të zhvillimit të veprimtarisë së Bashkisë.

Pjesë e aparatit të Bashkisë janë dhe pozicionet politike, si Kabineti, Zevendes kryetaret, si dhe Njësitë Administrative.

Aparati Bashkise ka ne perberje 6 drejtori dhe 6 Njesite Administrative

Drejtorite kryesore te Institucionit


Nr.	Emertimi i drejtorise
1	Drejtoria e Integrimit dhe e Projekteve me BE
2	Drejtoria e Auditit te Brendshem
3	Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese
4	Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Teritorit dhe Prones
5	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar
6	Drejtoria e Bujqesise, Pyjeve, Kullotave dhe e Mjedisit
7	Drejtoria e Sigurise Publike
8	Drejtoe e Dr. se Taksave dhe Tarifave Vendore
9	Drejtoria e Turizmit Arsimit dhe e Kulturës
10	Drejtoria e Sherbimit Social
11	Qendra Kulturore e Femijeve
12	Drejtoria e Sherbimeve Publike

Aparati me drejtoritë dhe sektorët përbëjnë 18.9% të numrit përgjithshëm të punonjësve të Institucionit.

Funksionet me drejtoritë dhe sektorët përbejnë 54.6% të numrit të përgjithshëm punonjësve

Shërbimet janë të organizuara në një drejtori përbejnë 26.5% te numrit te pergjithshem te punonjësve

*Të gjitha këto struktura të ngritura për realizimin e detyrimeve ligjore dhe funksioneve të përcaktuara në ligj, kërkojnë numrin e punonjësve të propozuar në këtë projekt-vendim.*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_ . Date \_\_/\_\_/2025

**"PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONAREVE TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILE E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË LIBRAZHD DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISE"**

Këshilli Bashkiak Librazhd në mbledhjen e tij të \_\_\_/\_\_\_/2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 51, nenit 54 shkronja "c", ligjit nr.139, date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligji 7961, date 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë' të ndryshuar ; ligjit 152/2013, datë 30.05.2013 'Për nëpunësin civil' të ndryshuar; ligjit nr.35/2023, date 25.05.2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionei e administrates publike , si dhe të pagës bazë minimale në shkalle vendi", i ndryshuar; Vendimi nr.113, date 01.03.2023 i Këshillit të Ministrave "Për percaktimin e pagës minimale në shkalle vendi"; Vendimi nr.503, date 01.08.2024 i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr.328, date 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njesive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve dhe të punonjesve administrative të njesive të veteqeverisjes vendore", Vendimi nr. 422, date 26.06.2024 i Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në Vendimin nr.326 date 31.05.2023 të Keshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjesve të tjere të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administrates publike"Keshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë \_\_\_/12/2025. pasi dëgjoi propozimin e kryetarit të bashkisë :

V E N D O S I :

1. Të miratojë nivelin e pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të bashkisë Librazhd dhe institucioneve të varësise", sipas tabelave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efektet financiare fillojne nga data 01.01.2026 -31.12.2026 dhe do të përballohen me buxhetin e bashkisë të miratuar për vitin 2026 .
3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit , e Menaxhimit Financiar dhe Shërbimi Social .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes .

**Tabela nr.1**  
 Niveli i pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emeruar, të nëpunësve civil dhe punonjësve administrativë (nr.503, dt 01.08.2024 "Për disa ndryshime ne vendimin nr. 328 datë 31.05.2023 dhe neni 9/a, 9/h, 9/i i ligjit nr.35/2023 "Per kopesenca percaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të punësuarve dhe institucioneve administrative publike, si pagës baze minimale në shkallë vëndi I ndryshuarar.

Nr.	Pezicionet e punes	Niveli Arsimor	Klasat	Paga e punonjesve me arsim te larte					Grafik
				Kategoria	Paga e Grupit	Vjetesia 0.6% (1-10 vite) 0.8% (11-20 vite) 1%(21-30 vite)	Shtesa per Pozicion		
<b>Funksionar të zgjedhur</b>									
	Kryetari	I larte		Jidhja 1,5				230,000	
2	Sekretar I Keshillit Bashkise	I larte	II-2	II				130,000	
<b>Funksionar të emeruar</b>									
1	ZV/Kryetari	I larte		Jidhja 1,5	1	0.6% (1-10 vite) 0.8% (11-20 vite)		175,000	
